

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI

Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA

Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7363 E premte 24 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga HASAN LUÇI

Litari grek, si i Nastradinit jashtë varrit



Bisedimet treditore në Kretë me ministrave të Jashtëm, shqiptar e grek mbaruan me premtime për t'i vazhduar edhe në Tiranë, inshalla jo në kalendat greke ...
Vijon në faqet 18-19

Opinion

Ditës

Nga JULIAN ZYLA

Krimi dhe politika, çfarë duhet të komunikojë PS dhe PD



Ja si e niste kryeministri opinionin e tij në gazetën britanike "Financial Times": "Jam shumë i vetëdijshëm që disa njerëz, nëse përmend Shqipërinë ...
Vijon në faqen 19



Skema për pagesat e përshpejtuara
Ministria Gjonaj: Si do të ndahen 30 milionë USD për ish-pronarët

Fondi për vitin 2018, ja cilat kategori përfitojnë të parat kompensimin

Nga ORNELA MANJANI

Ish-pronarët do të kenë në dispozicion një fond prej 30 milionë dollarësh për vitin e ardhshëm. Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, gjatë raportimit në Komisionin e Ekonomisë ka folur për kompensimin e pronarëve, ku sipas saj janë përdorur ...
Në faqen 9

PROKURORIA, KONTROLL BANESAVE TE TE AKUZUARVE PER LIDHJE ME "HABILAJT", PROVAT

"ZHDUKJA" E TRE POLICEVE, RAMA: HETIM DEKONSPIRIMIT

Sot Xhafaj dorëzon kallëzimin penal, Basha: Ishte qeveria që nxori sekretin hetimor. Diplomati amerikan në OSBE: Tahiri, i implikuar



(Në foto) Kryeministri Edi Rama. Sokol Bode majtas në rreth dhe Moisi Habilaj në mes



"TE SHPORRET QEVERIA"
Kryemadhi: Rama e Tahiri e dinë ku fshihen të kërkuarit e drejtësisë
Në faqen 7

ISH-AMBASADORI I SHBA

Arvizu: Akuzat ndaj Tahirit, serioze. Meta, presidenti i duhur
Në faqet 14-15

ELIMINATORET

Skënderbeu del kokëlartë nga Liga e Europës, mund 3-2 Kievin
Në faqen 21

KUSH SUBVENCIONOHET

Reforma e ujit, familjet pa matës, afat deri në shkurt për vetëdeklarim
Në faqen 8

INTERVISTA



Ish-kryepolici Prenç: Prokuroria e vonuar, provat i kishte para Italisë
Në faqet 4-5

Këshilli bashkiak vendos: 4 shkolla publike, me trajtim ushqimor e studim

Rriten me 2 për qind rrogat e zjarrfikësve

Veliaj: Kategoritë që përfitojnë ndihmë ekonomike nga bashkia

Nga VOLTIZA DURO

Gjatë mbledhjes së këshillit bashkiak të zhvilluar ditën e djeshme janë miratuar disa vendime të rëndësishme që do t'u vijnë në ndihmë shtresave sociale dhe nxënësve. Por jo të pakta



kanë qenë edhe reagimet e debatet gjatë mbledhjes, ku në seancën e dytë anëtarët e Partisë Demokratike nuk morën pjesë. Ky vendim për të braktisur mbledhjen nga ana e PD-së erdhi pasi sipas tyre, grupi i mazhorancës po tentonte të ...
Në faqet 12-13

ÇESHTJA "TAHIRI" REAGIMET

Në kërkim 3 ish-zyrtarët, MB: Nga kontrollat në banesë gjetëm prova me vlerë

Dosja "Habilaj", dekonspirohet operacioni, dëshmon kreu i SHÇBA 8 zyrtarë të tjerë të policisë, nën hetim

Ina Allkanjari

Pas lëshimit të urdhër arresteve nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për 3 ish-zyrtarët e lartë të policisë së Vlorës, në kuadër të hetimit të dosjes "Habilaj", policia ngre dyshime se operacioni është dekonspiruar. Kjo për faktin se nuk është kryer ende asnjë arrestim, pasi asnjë nga ish-zyrtarët nuk është gjetur. Bëhet me dije se dhe Prokuroria për Krime të Rënda ka thërritur për të dëshmuar drejtorin e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Policinë e Shtetit, Eduart Merkaç, lidhur me dyshimet për dekonspirimin e aksionit. Ndërkohë, kontrollet e ushtruara në banesat e ish-zyrtarëve Jaeld Çela, Gjergj Kohila dhe Sokol Bode janë sekuestruar prova materiale të konstatuara si me vlerë për hetimet e mëtejshme dhe janë dërguar zyrtarisht Prokurorisë për Krime të Rënda, Tiranë. Sakaq, burime nga prokuroria deklarojnë se janë edhe 8 zyrtarë të tjerë nën hetim për trafik të lëndëve narkotike.

HETIMET

Ministria e Brendshme reagon për herë të parë pas lëshimit të urdhër-arresteve nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për tre ish-zyrtarët duke sqaruar se pavarësisht kontrolleve të ushtruara në banesat dhe vende ku dyshohet se mund të strehoheshin ish-zyrtarët Çela, Bode dhe Kohila, nuk është bërë e mundur gjetja dhe ndalimi i tyre. 3 ish-zyrtarët janë shpallur në kërkim dhe ka dyshime të forta se janë larguar jashtë vendit. Gjithashtu, ndaj tyre është marrë vendim për përjashtim nga radhët e Policisë së Shtetit. Mësohet se ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, ka kërkuar sqarime nga vartësit e tij, pasi dyshohet se oficerë apo zyrtarë të tjerë dekonspiruan operacionin, ku u bë i mundur dhe



(Në rreth)
Habilaj me një ndër policët e shpallur në kërkim



largimi i ish-zyrtarëve. Bëhet me dije se shumë pak persona kanë pasur dëgjime për emrat e ish-zyrtarëve që kërkoheshin për t'u arrestuar. Ndërkohë, kreu i prokurorisë për Krime të Rënda, Besim Hajdarmataç ka thërritur mëngjesin e së enjtes Edi Merkaç, drejtuesin e Shërbimit të Ankesave dhe Çështjeve të Brendshme. Merkaç është kërkuar për të analizuar arsyet e moskoordinimit mes institucioneve, gjë e cila u krijoi mundësinë të ish-drejtesve të policisë të zhduken pa gjurmë. Në datë 22 nëntor 2017, rreth orës 10:30 minuta, Shërbimi për

Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) në Ministrinë e Brendshme ka marrë nga Prokuroria për Krime të Rënda dy urdhra-ndalimi dhe një vendim të Gjykatës për Krime të Rënda, për masë sigurie në mungesë "Arrest në burg". Urdhër-ndalimet janë nxjerrë për shtetasit: Jaeld Çela, ish-drejtor i Policisë Vendore Vlorë, liruar nga detyra dhe nxjerrë në dispozicion që prej muajit prill 2017, i dyshuar për veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike" dhe "Trafikimi i narkotikëve", të kryer në bashkëpunim në formë të posaçme të grupit të strukturu

ruar kriminal. Gjergj Kohila, ish-shef i Sektorit Kundër Krimin të Organizuar në Vlorë, liruar nga detyra dhe nxjerrë në dispozicion që prej muajit maj 2017, i dyshuar për veprat penale "Kultivimi i narkotikëve" dhe "Grup i strukturuar kriminal". Vendimi i gjykatës në mungesë për masën e sigurisë "Arrest në Burg" është nxjerrë për shtetasin Sokol Bode, ish-shef i Postës së Policisë Kufitare Dhermi, Vlorë, i pezulluar nga detyra në datë 25 tetor 2017, i dyshuar për veprat penale "Kultivimi i narkotikëve" dhe "Grup i strukturuar kriminal".

Në sekuestro 2 kg e 384 gr lëndë narkotike

Aksion antidrogë në Tiranë, në pranga 3 persona, mes tyre një femër

TIRANË - Uniformat blu kanë goditur dy raste të prodhimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike ditën e mërkurë. Policia e Tiranës bën me dije se janë arrestuar 3 persona dhe nga operacioni janë sekuestruar 2 kg e 384 gr lëndë narkotike, armë, fiskekë, mjet tip "Ford" dhe një aparat celular "iPhone". Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve në bashkëpunim me shërbimet e posaçme "Shqiponja", të Drejtorisë Vendore të Policisë "Tiranë, në rrugën "Ibrahim Rugova" kanë arrestuar në flagrancë shtetasit: Elia Shahu, 21 vjeç, banues në Tiranë dhe Fat-

jon Ormani, 21 vjeç, banues në Tiranë. Këta dy shtetas shpërndanin lëndë narkotike të llojit kanabis sativa. Gjatë kontrollit fizik iu gjetën dhe sekuestruan 26,8 gr lëndë e dyshuar narkotike të llojit kanabis sativa". Gjithashtu, në vijim të kontrolleve të ushtruara në zonën e Paskuqanit u arrestua shtetasi Elton Laçi, 24 vjeç, banues në Tiranë. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën dhe lokalit të këtij shtetasi u gjetën dhe sekuestruan 2 kg e 357 gr lëndë e dyshuar narkotike e llojit kanabis sativa, 1 armë gjahu teke, 4 fiskekë model 56, mjet tip "Ford", 1 telefon tip "iPhone 5".

FATMIR XHAFAJ

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, ka kërkuar sqarime nga vartësit e tij, pasi dyshohet se zyrtarë të tjerë dekonspiruan operacionin, ku u bë i mundur edhe largimi i ish-zyrtarëve. Bëhet me dije se shumë pak persona kanë pasur dëgjime për emrat e ish-zyrtarëve që kërkoheshin për t'u arrestuar.



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri (në mes)

Deputeti i PS

THIRRJA

Deputeti i PS, Pjerin Ndreu, ka reaguar në "Facebook" në lidhje me tre ish-drejtesit e policisë së Vlorës. Ndreu shkruan: "Shmangia nga ekzekutimi i arresteve është e papranueshme për një ish-zyrtar të rangut të lartë. Të paraqiten para drejtësisë e të japin dëshmi për akuzat".



Dyshohet si trafikant droge

Prokuroria kërkon sekuestro të resortit "Santa Quaranta" të Klemend Ballilit

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar nga gjyka të vendosjen e sekuestros për disa prona të familjes së Klemend Ballilit, ish-kreut të Transporteve në Sarandë, i dyshuar si trafikant droge. Ballili është ende person në kërkim për llogari të drejtësisë greke dhe asaj shqiptare, pasi dyshohet se drejtoje një grup kriminal të trafikut të drogës drejt Europës. Por tashmë kur ka kaluar një vit nga verifikimi i pasurisë së familjes së Klemend Ballilit, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar vendosjen e sekuestros preventive për mostjetësimin e disa pronave të kësaj familjeje, mes tyre edhe për resortin turistik "Santa Quaranta". Pjesë e kërkesës së prokurorisë janë disa prona, si troje, dyqane, shtëpi private dhe disa apartamente në Sarandë. Momentalisht Ballili vijon të qëndrojë në kërkim policor. Strukturat policore kanë kryer disa kontrolle në zonën e Delvinës dhe Sarandës, por s'kanë arritur të gjejnë asnjë gjurmë të Klemend Ballilit.



Klemend Ballili



Deklarata e fortë e përfaqësuesit të SHBA në OSBE: Kriminalitetit, pengesë

Kamian: Tahiri mbështeti trafikantët e drogës



Përfaqësuesi i SHBA-ve në OSBE, Harry Kamian

Përfaqësuesi i SHBA-ve në OSBE, Harry Kamian deklaroi në Vjenë se, "korrupsioni dhe kriminaliteti mbeten pengesat për zhvillimin e Shqipërisë". Ai foli edhe për çështjen "Tahiri", në një koment që erdhi si përgjigje e raportit të mbajtur para tij nga kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ambasadori Bernd Borchardt. "Në një situatë të tillë, një ish-ministër i Brendshëm, i cili tani është anëtar i Parlamentit, është implikuar në Itali për mbështetjen e trafikantëve të drogës", tha i ngarkuari me punë i SHBA në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së në Vjenë. "Korrupsioni dhe kriminaliteti në të vërtetë

mbeten pengesa për prosperitetin në Shqipëri. Prokurori i Prokurorisë së Tiranës po heton aktualisht më shumë se 3,000 raste të marrjes në punë dhe shkarkimit të

përkrahësve partiakë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore 2017, një shqetësim që është ngritur edhe nga ODIHR. Në njërin nga rastet, një ish-ministër i Brendshëm, i

cili tani është anëtar i Parlamentit, është implikuar në Itali për mbështetjen e trafikantëve të drogës. Z. ambasador, duke iu drejtuar këtyre dhe problemeve të tjera, koordinimi midis aktorëve ndërkombëtarë do të vazhdojë të jetë një nga çelësat e suksesit", thuhet në reagimin e Kamian. Ambasadori Kamian në emër të SHBA-ve ka falënderuar ambasadorin e OSBE në Tiranë për punën e madhe dhe për qasjen bashkëpunuese të misionit për të ndihmuar Shqipërinë të ecë përpara në rrugën e saj demokratike dhe euroatlantike. Teksa vlerëson raportin e OSBE-së për zgjedhjet në Shqipëri, ambasadori amerikan pranë zyrave qendrore të OSBE-së në kryeqytetin austriak

thekson se SHBA-të mbështesin takimin e parë të komisionit ad hoc për reformën zgjedhore në Shqipëri. "Rrjedhimisht, Shtetet e Bashkuara përsëriten takimin e parë të komitetit ad hoc të reformës zgjedhore të Shqipërisë më 10 nëntor. Z. ambasador, unë e mirëpres për kushtimin tuaj që ju paraqitni në deklaratën tuaj për të punuar ngushtë me ODIHR. Ne inkurajojmë komitetin që të ndërmarrë hapa realë - në koordinim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri - për të zbatuar rekomandimet e ODIHR dhe të Komisionit të Venecias", tha i ngarkuari me punë i SHBA në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së në Vjenë.

Kryeministri: Tahiri, një "vemje" nëse drejtësia provon akuzat. Nuk tërhiqem nga përgjegjësia

"Habilaj", Rama: Xhafaj, kallëzim penal për dekonspirim
"Numri i personave që kanë pasur dijeni është i kufizuar"

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje se ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj do të bëjë sot një kallëzim penal për ata që kanë dekonspiruar operacionin për arrestimin e ish-drejtesve të lartë të policisë së Vlorës. Në një intervistë në "360 Gradë" në "OraNews", Rama tha se është një grup i vogël që kanë dijeni për çështjen. Po kështu, kryeministri u shpreh se i qëndron deklaratës se nëse Saimir Tahiri shpallet fajtor nga prokuroria, është një "vemje", ndërsa nuk preferoi të komentonte deklaratën e ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Vjenë. "Ministri i Brendshëm nesër sot do të materializojë një kallëzim penal për të kërkuar një hetim të plotë për dekonspirimin e sekretit hetimor në rastin konkret, duke përfshirë të gjithë ata që kanë pasur dijeni, përfshirë edhe vetveten dhe duke vënë në dispozicion të organeve të hetimit të gjithë gatishmërinë e palës që përfaqëson pushtetin ekzekutiv dhe policinë, duke kërkuar të vihen në gatishmëri për hetimin edhe të tjerët edhe ai vetë. Numri i personave që kanë pasur dijeni për operacionin është i kufizuar dhe është mundësia për të pasur hetim për të shkuar



Kryeministri Edi Rama

drejt dekonspiruesit", u shpreh kryeministri Rama. I pyetur nëse do të ketë hetim edhe për opozitën, Rama u shpreh: "Unë po them diçka shumë të thjeshtë. Është një rast, i cili për fat të keq del në media përpara se sa të materializohet një operacion. Në rastin konkret ekziston dyshimi i arsyeshëm që është dekonspiruar operacioni. Ajo që duhet të bëjë ministri i Brendshëm është të kërkojë hetim për rastet e përsëritura. Nuk bëhet fjalë për të kallëzuar opozitën dhe median, por personat në dijeni për operacionin. Ministri i Brendshëm nuk autorizon hetime, bën një kallëzim penal. Dihet kush janë me emër dhe mbledhë dhe është po ashtu edhe pala e prokurorisë, sepse jemi në

një situatë qesharake, ku qytetarëve u serviret një mish-mash me gjysmë të vërteta. Në rastin konkret, numri i personave që kanë pasur dijeni është i kufizuar", theksoi Rama. Kryeministri sqaroi se në këtë kallëzim, "nuk ka asnjë tërheqje nga përgjegjësia, por domosdoshmëri për t'i shkuar deri në fund një hetimi për raste kur mediat apo podiumet politike kanë marrë përsipër të bëjnë gjyqe politike me të ashtuquajtura burime". I pyetur nëse e kanë gënjer për Tahirin, Rama u shpreh: "Këtë do ta tregojë drejtësia". "Nëse drejtësia do të provojë të kundërtën e atyre për të cilat unë e kam mbështetur vazhdimisht dhe i kam dhënë besim maksimal

ULSI MANJA

I ftuar në emisionin "Të Paekspozuarit" të gazetarit Ylli Rakipi në "News 24", deputeti i PS, Ulsi Manja komentoi 3 urdhër arrestet e prokurorisë për 3 ish-zyrtarët e policisë. "Është një situatë normale në gjykimin tim, pasi ka 27 vite që nuk është zbatuar ligji dhe opinioni publik nuk ka qenë mësuar me këto lajme. Ky është një procedim i filluar që në 2016-ën dhe uroj të mos jetë thjesht me materialet e përkythura të ardhur nga Katania, por të ketë prova nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Një oficer policie duhet të dorëzohet para drejtësisë lidhur me ato akuzat që ngarkohet", - tha ai.

Saimir Tahirit, i qëndroj 100% asaj që kam thënë. Atëherë ai është jo ai që unë kam besuar, por një njeri që meriton fjalën vemje", u shpreh kreu i qeverisë. Kreu i qeverisë pohoi se, "nuk kemi asnjë hetim ndërkombëtar dhe as tërheqje misterioze të shefit të Shërbimit. Ka një hetim të brendshëm". Sa u përket reagimeve të ndërkombëtarëve, Rama tha: "Reagimi im dhe i PS-së është në përputhje të plotë me reagimet ndërkombëtare". Kreu i qeverisë tha se sa u përket përgjimeve, "prokuroria e Katantias nuk ka nxjerrë asgjë. Ato përgjime janë në dosjen e mbyllur hetimore dhe prokuroria ia çoi gjykatës. Ato përgjime janë nxjerrë në median shqiptare. Unë kam një qëndrim të qartë. Mbi këtë çështje nuk komentoj për përmbytjen, nuk komentoj për

fajësinë apo pafajësinë e kujt do sot dhe nesër që ka një çështje për të zgjidhur me drejtësinë. Unë nuk jam Saliu, që sulmonte prokurorinë kur prokuroria ngrinte akuzë për ministrat e tij", theksoi Rama. I pyetur për deklaratat e përfaqësuesit të SHBA-ve në OSBE, Rama tha: "Nuk është i pari që e thotë. Nuk jemi ne që themi se krimi dhe korrupsioni nuk e pengon Shqipërinë. Ky është një qëndrim i thjeshtë në OSBE. Di që ish-ministri është nën hetim në Shqipëri dhe jo Itali dhe për sa kohë hetimi nuk ka dhënë këtë rezultat, nuk jam dakord me këtë shprehje".

KRIMI

Ai përsëriti vlerësimet për punën e Policisë së Shtetit në luftën kundër drogës dhe kriminalitetit. "Gjatë këtij viti, policia ka shifrën më të lartë të zblulueshmërisë së krimeve në his-

torikun e shifrave dhe këtë vit, Shqipëria ka numrin më të ulët të vrasjeve. Për sa i përket rastit konkret, unë nuk dua të bëj replika", u shpreh Rama. I pyetur për rastin e "Balilit", kryeministri tha: "Ka edhe raste të tilla dhe nuk ekziston në asnjë shtet që të ketë kapje 100% të autorëve të kërkuar. Për rastin konkret, unë nuk dua të bëjë replika me opozitën. Opozita është në një proces të vetin dhe nëse ka një subjekt që është dukshëm në drejtim të paditur, është opozita".

Rama vuri në dukje edhe raportin e mbjelljes së kanabisit në Shqipëri që nga viti 1991 dhe të dhënat që janë të Guardia di Finanza. "Asnjëherë nuk e kam mohuar problemin. Unë kam qenë dhe jam edhe sot tërësisht refuzues të politizimit ekstrem dhe njollosjes së vendit ndaj një opozite, që kujton se gjeti çelësin e derës së pushtetit dhe e gjeti. Në rastin konkret, me ministrin e Brendshëm italian nuk jam takuar, sepse kam pasur një angazhim të ndërmarrë më parë. Me Guardia di Finanza kemi rezultate spektakolare. Është e vërtetë që po Guardia di Finanza thotë se vitin e shkuar janë shkatërruar nga ato që janë identifikuar, 98% e kanabisit", theksoi Rama.

SITUATA E RENDIT

INTERVISTA

"Ambasadori Lu di detaje të tjera dhe si funksionojnë grupet dhe familjet mafioze"

"Tahiri", Prenci: Prokuroria është e vonuar, provat i kishte para Italisë

"Paratë e krimit mund të përdoren për terrorizëm"

Valentina Madani

Ahmet Prenci, ish-drejtori i Policisë së Shtetit jep alarmin se krimi i organizuar ka para në dorë më shumë se buxheti i shtetit, çka sipas tij e cenon sigurinë kombëtare. Z.Prenci paralajmëron përmes "Gazeta Shqiptare" se këto para mund të kanalizohen dhe për terrorizëm, pasi janë krejt të qetë e të sigurt në përdorimin e tyre. Z.Prenci flet për "peshqit e mëdhenj" të krimit, për të cilët thotë se ambasadori Lu di shumë detaje për ta, dosjen "Habilaj" dhe implikimin e ish-ministrit të Brendshëm me krimin, fletarrestet për zyrtarët e lartë të policisë. Z.Prenci shpreh rezervë për punën e Prokurorisë së Përgjithshme, ndërsa akuzon policinë për lidhjet me bandat kriminale.

Z.Prenci, si ish-drejtuës i Policisë së Shtetit, si e vlerëson situatën e rendit në vend?

Për mendimin tim, situata e rendit dhe e sigurisë publike në vend është në gjendje kritike. Zhvillimet e fundit, në një mënyrë ose tjetër, drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë shkaktuar një tërmet të jashtëzakonshëm në institucionet e sigurisë. Policia është në një presion të paprecedent. Nuk diferencojmë dot punonjësin e policisë të përfshirë në vepra kriminale, me punonjësin e ndershëm të organizatës së policisë. Imazhi i policisë sot është në nivelet më të ulëta. Po të kapim vetëm aspektin e policisë si një nga institucionet me peshë specifike më të madhe të luftës kundër krimit, e shikoj si një organizatë të tulatur, të çorganizuar në misionin e saj, të pamotivuar dhe e pamundur për të kryer rolin që i jep Kushtetuta dhe ligji i Policisë së Shtetit. E them këtë, pasi për rreth 4 vjet u drejtua nga një ministër aventurier, që mori atributet e drejtimit politik dhe teknik të policisë, krijoi një kasë drejtuesish policie me orien-



Ahmet Prenci, ish-drejtori i Policisë së Shtetit

tim të qartë, për ta inkriminuar policinë dhe gjithë shoqërinë me veprën e turpshme e kriminale, të kanabizimit të gjithë vendit. Kjo u realizua me një platformë të pastër shtetërore. Të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit që nuk kanë përfutur nga ky aktivitet i jash-tëligjshëm (që janë shumica), por kanë përjetuar dhe parë se si u zhvillua gjithë ky aktivitet, janë të shokuar, janë

"TAHIRI"
"Provat për Tahirin, Prokuroria shqiptare i ka pasur pa ardhur dosja nga Italia, pa përgjimet e Habilajve, pa Audi-n e famshëm, pa Zaganin e oficerë të tjerë kurajozë, që u ndëshkuan se thanë të vërtetën për lidhjet e ish-ministrit me trafikun e drogës, pa patentat e milionat e eurove që iu dukën para xhepi", tha Z.Prenci.

të pamotivuar dhe të denigruar në punën dhe misionin e tyre. Me një pjesë të mirë që kam kontaktuar, ata shprehën se me situatën e krijuar ndjehen të turpëruar që janë pjesë e kësaj organizate. Punonjësit e ndershëm të policisë kanë parë se si drejtuesit e tyre janë bërë njësh me drejtuesit e grupeve kriminale të trafikut të drogës, dinë paratë e pista që kanë përfutur dhe sot nuk kemi asnjë prej tyre të arrestuar. Asnjërit prej tyre nuk u janë sekuestruar paratë dhe asetet që kanë përfutur nga ky aktivitet kriminal. Të mos harrojmë që janë mbjellë 219

000 ha tokë me kanabis sativa, tonelata të kapura nga autoritetet italiane, greke e vende të tjera të Europës. Dhe këto tonelata janë vetëm 10% e sasisë, pasi 90% e sasisë kanë vajtur në destinacionin e dëshiruar nga trafikantët. Po të shikosh përfutimin e parave nga kanabisi, heroina dhe kokaina, në Shqipëri krimi i organizuar ka para në dorë, gati më shumë se buxheti i shtetit. Ky është cenimi më serioz i sigurisë kombëtare. Me këto para krimi i organizuar nuk sjell të mira publike në rrugë, në paga e pensione; por blen pushtet, blen drejtësinë, konkurren e falimenton çdo biznesmen të ndershëm, vret dhe realizon qëllimet e veta kriminale. Këto para mund të kanalizohen edhe për terrorizëm, pasi janë krejt të qetë e të sigurt në përdorimin e këtyre parave.

Ka të drejtë ambasadori Donald Lu kur flet për ekzistencën e 4 grupeve kriminale dhe 20 familjeve mafioze në Shqipëri, ndërkohë që në janar ka kërkuar arrestimin e "peshqve të mëdhenj"?

Mbështes përpjekjet e ambasadorit amerikan Lu dhe të gjithë faktorin ndërkombëtar, që kërkojnë produkt konkret në luftën kundër krimit të organizuar. Rëndësi themelore ka që ligji të veprojë i barabartë për të gjithë, i shtrirë në kohë dhe hapësirë dhe të mos politizohet asnjë proces ligjor. E kam thënë edhe herë tjetër që ambasadori Doland Lu, i cili bën këtë deklaratë di dhe detaje të tjera se kush janë dhe si funksionojnë këto grupe kriminale dhe familje ma-

fioze. Krimi mund të marrë revansh dhe të jetë më i fuqishëm se shteti në momente të caktuara, por gjithmonë strukturat shtetërore e kanë fituar luftën me krimin. Në situatën e tanishme si asnjëherë i kemi bashkë krimin dhe pushtetin, funksionojnë bashkë, ndajnë punë publike bashkë, kultivojnë e trafikojnë drogën bashkë. Në kushtet kur shteti dhe krimi janë bashkë dhe shkëmbejnë favore mes tyre, kemi të bëjmë me mafie. Prandaj është situatë alarmante, është situatë shumë e vështirë që po kalon vendi. Pse në janar arrestimi i kapove të krimit në Shqipëri?! A është normale që institucionet ligjbatuese të shtetit të zhvillojnë këtë luftë me muajt dhe fushata, ndërkohë që në çdo sekond të ditës dhe natës, në të gjithë muajt e vitit ata paguhen nga shoqëria shqiptare për të përmbyshur misionin e tyre, pra për të parandaluar, hetuar, arrestu-

AMBASADORI
"Ambasadori Doland Lu di edhe detaje të tjera se kush janë dhe si funksionojnë këto grupe kriminale dhe familje mafioze. Krimi mund të marrë revansh dhe të jetë më i fuqishëm se shteti në momente të caktuara, por gjithmonë strukturat shtetërore e kanë fituar luftën me krimin", tha Z.Prenci.

ar e dënuar këta kriminelë, që duke shkelur ligjin, kryejnë krime, pasurohen, marrin peng të ardhmen e vendit dhe u dashka të presim afatë për të goditur veprimtarinë e tyre! Pse në 5 vite nuk u arrestua asnjë nga këta koka të krimit?! Ligji duhet të veprojë njëjloj në të gjithë vendin dhe forca e tij në çdo kohë godet cilindo që përfshihet në aktivitet kriminal.

Sipas jush, ka dijeni Policia e Shtetit për grupet kriminale dhe çfarë ka bërë policia për goditjen e tyre? Po lidhja e krimit me politikën?

Organizata e policisë është e tulatur nga ajo që ka

ndodhur këto vite. Në magazinën e të dhënave që ka Policia e Shtetit dhe që e pasuron në çdo moment, ka informacion për gjithçka dhe për këdo që ka tendencë e prijje për të kryer krime. Problemi thelbësor është vullneti politik dhe këtë më mirë se askush tjetër e ndjejnë punonjësit e Policisë së Shtetit. Ky vullnet i ka munguar totalisht policisë. Mendoj që të dhënat dhe informacionet janë, por fakti që për 5 vjet policia nuk ka arrestuar asnjë nga anëtarët e familjeve mafioze apo kreer të grupeve kriminale tregon se ajo i ka duart e lidhura pikërisht nga vullneti politik. Punonjësit policie kanë parë, dëgjuar, nuhatur që në fillim frymën e ministrit të Brendshëm që themeloi "policinë që duam" dhe kanë parë çdo ditë se çfarë synimi kishte ai ministër me drejtues policie të emëruar prej tij. Policia e di më së miri se kush ka akses për të fituar tenderë publikë në të katërta anët e vendit, di më së miri se kë mbrojnë ministri e kryeministri, kë takojnë; dinë se si i shtojnë pasuritë e si i shpenzojnë paratë e fituara në rrugë të paligjshme. Kjo polici ka qenë në kohën që unë isha pjesë e saj, që në Itali për një vit u kapën 4 kg kanabis, por kjo polici është sot që në Itali kapen tonelata në javë. Kjo polici është keqpërdorur dhe e shantazhuar nga bota e krimit i lidhur ngushtësisht me politikën.

Si e konsideroni dosjen "Habilaj" dhe çfarë informacionesh keni pasur ju në kohën kur drejtonit Policinë e Shtetit?

Dosja "Habilaj" ka të bëjë me trafikun ndërkombëtar të drogës. Në kohën që kam drejtuar unë Policinë e Shtetit, siç e thashë më lart, bazuar në statistikat e policisë italiane, në një vit janë kapur 4 kg drogë. Vetëm Habilajt në këtë periudhë të flasin kanabis trafikuar tonelata. Unë nuk shikoj krahasim për sa i përket këtij fenomene. Ne, me autoritetet ligjbatuese italiane kishim një marrëdhënie të admirueshme si në aspektin e besueshmërisë, edhe në



Ahmet Prenci dhe kreu i PD-së, Lulzim Basha në "Çadrën e lirisë"

produktivitet. Në një vit janë kryer 84 operacione të përbashkëta, ku paralelisht arrestonim pjesëtarë bandash si në Itali, si në Shqipëri. Ky bashkëpunim përmendet në Bruksel nga homologët si një histori suksesi për sa i përket bashkëpunimit policor ndërshtetëror. Duhet të kujtojmë se këto rezultate hoqën vizat për shqiptarët dhe na anëtarësuan në NATO.

Cili është gjykimi juaj për çështjen "Tahiri", rrjedhën e ngjarjeve e provave që e implikojnë atë me krimin?

Të them të drejtën, gjatë gjithë kohës mua më habiste euforia e një ministri aventurier, që unë për vetë ia parashikoja fundin dhe këtë e kam shprehur mes miqsh e kolegesh. Mua më habiste fakti që ai po bënte atë që bëri dhe nuk kishte frikë për të nesërmen e tij. Dhe jo vetëm kaq,

FLETARRESTIMET
"Për sa u përket vendimeve të arrestit për disa drejtues të policisë, prokuroria është e vonuar. Duhet ta kishte bërë këtë që në fillasat e këtij aktiviteti kriminal. Këta drejtues e të tjerë janë bashkëpunëtor të ngushtë të ish-ministrit Tahiri", tha Z.Prenci.

por së bashku me kryeministrin krenoheshin për situatën që krijuan. Autoritetet e Antimafies italiane janë më të suksesshmet në botë në këtë fushë dhe puna profesionale e tyre është për t'u admiruar. Nuk mundet as ish-ministri Tahiri dhe askush tjetër të vë në diskutim precizionin e tyre kur godasin. Trafiku ndërkombëtar i drogës është vepër e rëndë penale dhe shumë komplekse, që hetohen vetëm me masë sigurie arrest në burg. Për mua jo Antimafia, por Prokuroria shqiptare duhet të kishte hetuar dhe duhet të kishte kërkuar arrestimin e tij dhe të drejtuesve të policisë që kriminalizuan ven-



Kryeprokurori i ri, kreu i PD: Do të bllokojmë Ramën me çdo mënyrë

Fletarrestet, Basha: Qeveria dekonspiroi arrestimin e policëve

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Luzlim Basha, akuzon kryeministrin Edi Rama si përgjegjës për kapjen e drejtësisë dhe mbrojtjen e bandave kriminale, ndërsa Saimir Tahirit, Vangjush Dakos dhe Qazim Sejditin i jep mbrojtje politike. Basha akuzoi në mënyrë të drejtpërdrejtë Ministrinë e Brendshme se fshihet pas dekonspirimit të aksionit për arrestimin e tre ish-zyrtarëve të lartë të policisë, në kuadër të hetimeve që Prokuroria e Krimeve të Rënda ka nisur për dosjen "Habilaj". Sipas kreut të demokratëve, implikimi në trafikun e drogës i tre ish-kreujve të policisë është dëshmi e funksionimit të saj si organizatë kriminale. "Liria e Saimir Tahirit, dekonspirimi kriminal nga vetë Ministria e Brendshme i aksionit të djeshëm për arrestimin e kokave të policisë janë aktet dhe provat që konfirmojnë këtë fakt", theksoi z.Basha. Sipas tij, kriminalizimi i policisë dhe aktiviteti i trafikimit të drogës është bërë me bekimin e kryeministrit, të cilin e akuzoi se e ka thyer Shqipërinë në zonë të lirë për krim. "Policia ka



Kreu i PD-së Luzlim Basha

DEKONSPIRIMI

Z.Basha akuzoi Ministrinë e Brendshme se fshihet pas dekonspirimit të aksionit për arrestimin e tre ish-zyrtarëve të lartë të policisë, në kuadër të hetimeve që Prokuroria e Krimeve të Rënda ka nisur për dosjen "Habilaj".

KRIMI
"Po të shikosh përfitim të parave nga kanabis, heroina dhe kokaina, në Shqipëri krimi i organizuar ka para në dorë gati më shumë se buxheti i shtetit. Ky është cenimi më serioz i sigurisë kombëtare".

← din. E gjithë situata e dosjes që implikon Tahirin në trafikun e drogës është vetëm aparenca e asaj çfarë ka ndodhur në të vërtetë. Provat për Tahirin, Prokuroria shqiptare i ka pasur pa ardhur dosja nga Italia, pa përgjimet e Habilajve, pa "Audi" në famshëm, pa Zaganin e oficerë të tjerë kurajozë, që u ndëshkuan se thanë të vërtetën për lidhjet e ish-ministrit me trafikun e drogës, pa patentat e milionat e eurove që u duken para xhepi. Prokuroria kishte 219 000 ha kanabis të mbjella, tonelata kanabis të kapura nga autoritetet e huaja, pistat e avionëve që transportonin e trafikonin drogë, mijëra qytetarë që punonin në të katërta anët si skllëvër etj., që në çdo rrethanë sikur edhe për neglizhencë apo mosveprim, Tahiri si drejtues politik e teknik i Policisë së Shtetit ka përgjegjësi penale.

këpunëtor të ngushtë të ish-ministrit Tahiri. Këto urdhra të vonuar arresti dhe të vetmit tregojnë tamam pasojën e argumentit që parashtrova më lart. Mosvetëdorëzimi i këtyre drejtuesve të policisë, e aq më keq moskapja e tyre është një turp. Prokuroria nuk duhet të mjaftohet vetëm me një dosje të ardhur nga Antimafia italiane. Nuk janë vetëm Habilajt që kanë kultivuar e trafikuar drogë. Nuk është kultivuar drogë vetëm në Vlorë. Ky hetim duhet të përfshijë të gjithë drejtuesit e policisë, në të gjitha qarqet e vendit, kudo ku është mbjellë drogë me bekimin e bashkëpunimit e policisë. Shpresoj të vazhdojë ky hetim dhe të gjithë drejtuesit e punonjësit e policisë që janë marrë me aktivitet kriminal duhet të përgjigjen para drejtësisë.

Cili është gjykimi juaj për punën e prokurorisë në raport me luftën kundër krimin dhe drogës?

Për mendimin tim, prokuroria nuk ka qenë në lartësinë e duhur të përmbushjes së detyrës. Siç e theksova edhe më lart, në këto vite u mbollën 219 000 ha drogë. Nën mbikëqyrjen e policisë u hapën toka të reja në të gjithë territorin e vendit, u ndërtuan rezervuare dhe u shtrinë mijëra km tubacion për vaditje, u ndërtuan pista avioni gjithandej për trafikun e drogës, u punësuan me mijëra njerëz për të kryer këto punime dhe nuk kemi parë reagimin ligjor të prokurorisë për të vënë para drejtësisë ideatorët, organizatorët e shumtë, financuesit dhe përfrituesit bandit ose pushtetarë. Në këtë pikë, unë nuk mund të them se prokuroria ka kryer punën e saj, për kundrazit e kundërta është më se e vërtetë. Unë e di se pa mbështetjen e policisë, prokuroria është e gjym-

funksionuar si një organizatë kriminale e strukturuar. Krimi i organizuar është sot një kërcënim serioz ndaj sigurisë kombëtare të Shqipërisë, si dhe rrezikon të sjellë destabilizimin e thellë politik, shoqëror dhe ekonomik të vendit", deklaroi kreu i PD-së. I pyetur në lidhje me emërimin e kryeprokurorit të ri me shumicë të thjeshtë nga parlamenti, Basha tha se opozita nuk do ta lejojë një vendim-marrje të tillë nga ana e mazhorancës. "Qëndrimet tona kanë qenë dhe janë të qarta, prokurorin e Përgjithshëm nuk mund ta emërojmë

Edi Rama. Ky që ndërmori një sulm të tillë ndaj prokurorëve vetëm sepse kërkuan arrestimin e Saimir Tahirit, nuk mund të emërojmë Prokurorin e Përgjithshëm. As deputetët e PS që e mbrojtën duke mos i hequr imunitetin nuk mund ta emërojnë Prokurorin e Përgjithshëm. Nuk mund ta emërojmë Prokurorin e Përgjithshëm miqtë e Saimir Tahirit, Vangjush Dakos, Qazim Sejditin. Një prokuror i emëruar nga këta njerëz do të thotë fund i hetimeve në rastin "Tahiri", në rastin e Dakos dhe fushë e lirë për krimin. Ne nuk do ta lejojmë

dhe nuk do ta pranojmë kurrë këtë. Për më shumë, kjo bie në konflikt total me frymën e Kushtetutës dhe të reformës në drejtësi. Për ta kuptuar absurditetin mjafton t'ju kujtoj se edhe vetë Saimiri ka të drejtë të votojë. Pra, i bie që një Prokuror i Përgjithshëm të zgjidhet edhe me votën e Saimir Tahirit dhe ky prokuror është ai që do të nxjerrë para drejtësisë Saimir Tahirin", u shpreh kreu i PD-së. Sipas Bashës, përmasë kapjes së prokurorisë, kryeministri po tenton të mbyllë hetimet për çështjen "Tahiri" dhe atë të kryebashkiakut të Durrësit.



Urdhërarrestet për katër zyrtarët e policisë Berisha: Rama firmos 'azilin politik'

Ish-kryeministri Sali Berisha ironizoi dje urdhërarrestet për katër ish-drejtuesit e policisë. Sipas tij, Rama u ka dhënë këtyre policëve azil politik në Shqipëri, pasi ata kanë mbrojtur Tahirin dhe nuk e lanë të arrestohet. "Narkodrejtorëve dhe baronëve të ndëruar të drogës Alban Cela, Gjergj Kohela, Sokol Bode dhe Jaeld Cela iu akordohet azili politik në Narkoshtetin e Sh-

qipërisë për kontributin e tyre tejet të çmuar në ndërtimin e Narkoshtetit. Këta baronë fisnikë të drogës punuan me përkushtim të madh për të shndërruar në realitet zotimin solemn elektoral të Edvin Kristaq Ramës para shqiptarëve se 'do ndërtoj më shtet', çka vetëkuptonte Narkoshtetin e parë në Europë dhe të dytin në botë!", shkruan Berisha në "Facebook".

Si i shikoni fletarrestet për disa drejtues të lartë të policisë?

Për sa u përket vendimeve të arrestit për disa drejtues të policisë, prokuroria është e vonuar; duhet ta kishte bërë këtë që në fillimet e këtij aktiviteti kriminal. Këto drejtues e të tjerë janë bash-

tuar, por në çdo lloj rrethane duhet të kishte reaguar për të dokumentuar këtë aktivitet kriminal me platformë shtetërore, të paktën për të përjashtuar veten nga kjo veprimtari kriminale poshtëruese për vendin.

Çfarë strategjie duhet të ndjekë qeveria për një goditje të fortë të krimin dhe a do ketë efekte Task Forca "Forca e Ligjit", që po funk-

sionon së fundmi si nismë e Ministrisë së Brendshme?

Unë mendoj që "Forca e Ligjit" është një spektakël i radhës, por nuk më bind që do realizojë atë që thotë. Të njëjtin gjë bëri Rama me Tahirin në Pallatin e Kongreseve për kanabisin dhe e pamë se si funksionoi(!). Nuk luftohet krimi me fushata. Kësaj i thonë: Hajde të krijojmë një Task Forcë që të

zbatojmë ligjin! Po deri më tani që nuk ka ekzistuar kjo Task Forcë, çfarë kanë bërë strukturat e luftës kundër krimin të organizuar në Policinë e Shtetit?! Kjo që bëri ministri Xhafaj me parandalimin e kultivimit, pse nuk ndodhi në 2015, po në 2016? Tani frenohet kultivimi se kanë vullnet politik?! Apo ngaqë ka superprodhim të magazinuar dhe oligarkët e

këtij aktiviteti nuk kërkojnë më për disa kohë, derisa të trafikojnë me mijëra tonë që ndodhen të depozituara?! Kjo mbetet për t'u parë në të ardhmen. Çelësi i fitores së luftës kundër krimin është vullneti politik. Kryeministri na ka bindur plotësisht se është ai, ideatori i situatës së krijuar dhe kurrsesi ai nuk zhbën dot atë që krijoi vetë me pasionin më të madh.

KREU I SHTETIT LIGJI

Presidenti u kërkon deputetëve ridiskutimin e çmimeve të padive

'Tarifat gjyqësore', Meta rikthen në Kuvend ligjin e qeverisë "Rama"

Mazhoranca e votoi më 19 tetor, opozita kundër

Darina Tanushi

Presidenti Ilir Meta riktheu dje për shqyrtim në Kuvend ligjin e miratuar pak ditë më parë "Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë". Ky është ligji i parë i depozituar nga qeveria "Rama" që rikthehet nga Presidenti Meta pa u dekretuar qëkurse ai ka marrë këtë detyrë. Kjo do të vërë edhe një herë në punë Kuvendin që ta shqyrtojë ligjin, ose ta miratojë siç është ligji. Ligji u miratua më 19 tetor, por pati debate në parlament. Opozita e kundërshtoi ligjin në fjalë, me argumentin se rëndonte pozitat e qytetarëve, pasi ata duhet të paguajnë më shumë për shërbimet në sistemin e drejtësisë. Mazhoranca nguli këmbë se këto tarifa do të përmirësojnë shërbimin ndaj qytetarëve në gjykata dhe do të rrisin edhe të ardhurat e këtyre institucioneve. Gjatë debatit që u bë për këtë çështje në Komisionin e Ligjeve, Partia Demokratike u shpreh përmes deputetit Eduard Halimi se tarifat rriten për të gjitha kategoritë dhe në shkelje kushtetuese. "Minimumi rriten 3 herë, maksimumi 25 herë. Çdo qytetar ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi. Sot tarifa, ta dinë qytetarët është 200 lekë, pra simbolike, pulla. E bëjmë 50 mijë lekë", tha deputeti demokrat, Eduard Halimi. Por mazhoranca, sipas deputetit Ulsi Manja shprehu të kundërtën. "Nuk sjell rritje të tarifave gjyqësore, por përcakton nivelin dysheme e tavan të këtyre tarifave, ku ministri i Drejtësisë dhe i Financave, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor do të caktojë tarifën gjyqësore", u shpreh Ulsi Manja, deputet i PS-së. Ligji i ri parashikon përjashtimin nga pagesa për personat që nuk kanë mundësi financiare dhe futen tek kategoria e atyre individëve që marrin ndihme juridike falas. Sipas ligjit që dje u riktheu për rishqyrtim në Kuvend, nga



Faksimile e dekretit të presidentit

Presidenti Meta, "për gjykimin e kërkesave civile, administrative dhe penale do të paguhet një tarifë fikse prej 2.500 (dymijepesëqind) lekësh". Ndërkohë një tarifë fikse prej 5.000 (pesëmijë) lekësh është parashikuar edhe për: gjykimet e ankimeve të veçanta, ankimit kundër një vendimi penal në Gjykatën e Apelit, paraqitjen e rekursit kundër një vendimi penal në Gjykatën e

Lartë, për çështjet penale me të dëmtuar akuzues; ndërkohë që ankimi për këto të fundit do të ketë si tarifë fikse shumën prej 2.500 lekësh. Tarifat janë përcaktuar me qëllim ruajtjen e ekuilibrit mes të ardhurave me satare minimale të Shqipërisë nga një anë dhe sigurimit të drejtës nga ana tjetër, shpjegohet në relacionin shoqëruar të ligjit. "Duke

qenë se sistemi i tarifave gjyqësore aktuale nuk reflekton shpenzimet për funksionimin e sistemit të gjykatave dhe taksapaguesit ngarkohen me barrën e mbajtjes së këtij shërbimi, ky ligj ka për synim kalimin, për sa të jetë e mundur, të kësaj barre, fillimisht, te palët ndërgjyqëse të cilët inicijojnë procesin gjyqësor", sqarohet nga relatorët e ligjit.

OPOZITA

Gjatë debatit që u bë për këtë çështje në Komisionin e Ligjeve, Partia Demokratike u shpreh përmes deputetit Eduard Halimi se tarifat rriten për të gjitha kategoritë dhe në shkelje kushtetuese. "Minimumi rriten 3 herë, maksimumi 25 herë", ka thënë Halimi.

ÇMIMET

Për gjykimin e kërkesave civile, administrative dhe penale do të paguhet një tarifë fikse prej 2.500 (dymijepesëqind) lekësh". Ndërkohë, një tarifë fikse prej 5.000 (pesëmijë) lekësh është parashikuar edhe për gjykimet e ankimeve të veçanta, ankimit kundër një vendimi penal në Gjykatën e Apelit, paraqitjen e rekursit kundër një vendimi penal në Gjykatën e Lartë, etj.

Ambasadorja e Holandës: Korrupsioni të luftohet nga qeveria

Dewi van de Weerd: Ka mungesë vullneti për reformën në drejtësi

Ambasadorja e Holandës në Shqipëri, Dewi van de Weerd tha dje se mungon vullneti për zbatimin e reformës në drejtësi. Sipas ambasadores holandeze, një nga proceset që po vonon reformën është moszgjedhja e anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor. "Ne kemi arritur shumë sa i përket legjislacionit, por jemi në fazën kur zbatimin i reformës ka nisur. Shoqëria civile ka një rol të rëndësishëm në ngritjen e institucioneve të drejtësisë dhe një nga proceset e vonuara është moszgjedhja e kandidatëve që vijnë nga Shoqëria Civile, arsyet mund të jenë të ndryshme, por për popullin shqiptar që beson në reformë duket si një mungesë vullneti për ta çuar procesin përpara", u shpreh ambasadorja holandeze. Ajo shtoi: "Ku ka vullnet, ka gjithmonë një zgjidhje dhe ne po flasim për një proces që po rihapet për herë të katërt sa u përket kandidatëve për KLP. Ne i duam këto organe për të shkuar më tej dhe për të thyer ngërçin aktual". "Shoqëria shqiptare nuk duhet që të dorëzohet, reforma në drejtësi është domosdoshmëri. Hapja e negociatave është e lidhur me reformën në drejtësi, e cila nuk është kalimtare. Është e nevojshme që duhet të ketë hapa konkretë për negociatat. Duhet të respektohen edhe të drejtat e njeriut. Korrupsioni mund të luftohet edhe nga ekzekutivi, jo vetëm nga reforma në drejtësi", tha ambasadorja. KLGJ dhe KLP nuk janë ngritur ende për shkak të mungesës së aplikantëve. Një ditë më parë, ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj tha se institucionet e reja të drejtësisë do të ngrihen menjëherë pas procesit të vetingut. Edhe kreu i shtetit informoi Kuvendin se nuk mund ta ngrite KED-në për shkak të vakumit ligjor.



Presidenti, në përurimin e shtatores së shenjtore në Porec të Kroacisë

Meta: Vepra e Shën Nënë Terezës të jetë udhërrëfyese për të gjithë ne

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, mori pjesë dje në ceremoninë e përurimit të të bekimit të shtatores së Shenjtore dhe bamirëses shqiptare, Nënë Tereza, me autor Anto Jurki?, të realizuar nga kryetari i Këshillit organizativ, Idriz Sulejmani dhe mbarë bashkësia shqiptare në bashkëpunim me Bashkinë e Porecit. Bashkë me Presidentin Meta ishin edhe kardinali Ernest Simonin (Troshani), kryetari i Kuvendit të Maqedonisë Talat Xhaferi, ish-presidenti i Kroacisë Stjepan Mesi?, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve Baba Edmond Brahimaj dhe shumë personalitete të tjera nga të gjitha trevat shqiptare. Në përshëndetjen e tij drejtuar të pranishmëve, Presidenti Meta u shpreh: "Jam shumë i lumtur që jam sot këtu për përurimin e shtatores së Shën Nënë Terezës, në këtë qytet, padyshim ndër më të bukurit në botë dhe padyshim që nga sot një nga qytetet më të dashura në botë për shqiptarët kudo që janë. Kroacia, ky vend mik dhe aleat i shqiptarëve gjithmonë ka treguar mikpritje për ne. Lidhjet tona miqësore dhe



vëllazërore me kroatët janë shekullore, janë lidhje gjaku dhe shpirti. Ato janë provuar në të gjitha kohërat që nga koha e heroit tonë kombëtar, Skënderbeu e vazhdojnë deri në ditët e sotme, ku ne kemi si ura shumë të forta shpirtërore Arbanasit e Zaris dhe diasporën tonë të mrekullueshme nga të gjitha trojet shqiptare që jetojnë në Kroaci". "Vlerat shpirtërore dhe humaniste të Nënës Terezës janë bashkim i vlerave më të mira të civilizimit njerëzor, por njëkohësisht edhe të civilizimit shqiptar e në mënyrë të veçantë ato shprehin frymën e tolerancës dhe kulturës së unitetit tonë kombëtar, edhe pse popull me përkatësi të ndryshme besimesh fetare". "Vepra e Nënë Terezës duhet të na udhëheqë në të ardhmen në punën tonë për një shoqëri më tolerante, më mirëkuptuese, me respekt të ndërsjellë dhe solidaritetin pa dallime sociale, etnike, kulturore apo religjioze. Sepse ishin këto vlera të mëdha, që e bënë Shën Nënë Terezën, nënën e të gjithë botës të adhuruar nga të gjithë qytetërimet", u shpreh Meta.



Kryetarja e LSI-së: Fronti opozitar të shporrë këtë qeveri

Kryemadhi: Rama e Tahiri e dinë ku fshihen të kërkuarit e drejtësisë

"Kryeministri ka frikë më shumë se Çako e 3 zyrtarët"

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi tha dje në një dalje për mediat se, "urdhër-arrestet për 3 ish-drejtesit e lartë të Policisë së Shtetit janë faktet më të fundit alarmante për të treguar që rendi nuk ekziston më në Shqipëri". Sipas saj, përfshirja në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike të kupolës së Policisë së Shtetit vërteton edhe njëherë akuzat e LSI-së dhe të një pjesë të medias se narkoshiteti nuk ka ndaluar aktivitetin e tij. "Përkundrazi - vijoi Kryemadhi - me fshehjen që po u bën 3 të akuzuarve të drejtësisë po vërteton përpara shqiptarëve se vijon të jetë pjesë e banditizmit të Habiljavë apo të bandave të tjera që kanë në pronësi drogën në Shqipëri". "Ky veprim i sotëm është në vazhdim të mbrojtjes së bandave të drogës dhe tregon edhe njëherë, se sot e kësaj dite nuk janë ndaluar nga policia 2 vëllezërit Habilaj, të cilët janë në kërkim. Askush më mirë se Edi Rama nuk e di se ku fshihen të kërkuarit e Drejtësisë", u shpreh kryetarja e LSI-së. Sipas saj, "ai së bashku me mikun e tij dhe bashkëpunëtorin e tij, Saimir Tahiri janë në dijeni të çdo lëvizjeje të tyre dhe janë në dispozicion të fshehjes së tyre. Kjo për faktin e thjeshtë se kanë frikë se nëse dikush nga ata flet, flet për çorbën që zien në kazzanin e krimin, e cila do të nxjerrë në krye të saj emrin e Edi Ramës, njeriu që mban përgjegjësinë kryesore për kanabizimin dhe banditizmin e qeverisjes në Shqipëri". "Njeriu që sot ka frikë më shumë se 3 policët e akuzuar për trafik, por edhe më shumë se sa vetë Haki Çako apo drejtues të tjerë të policisë që janë njësoj të implikuar në trafikimin dhe bashkëpunimin me bandat kriminale, me të njëjtat banda që garantuan fitoren me votat e blera, me paratë e krimin, të njëjtat banda që i japin sot garancinë Edi Ramës se do të vijojë të drejtë të Shqipërinë", akuzoi kryetarja e LSI-së. "Ndaj, sot më shumë se kurrë fronti ynë opozitar kundër krimin të organizuar dhe mafies që mban peng pushtetin e blerë me votat e drogës duhet të bashkohen forcat dhe të



shporrin njëherë e mirë nga pushteti këtë lloj politikani që është përlëyer në pazare dhe trafike me banditë", tha ajo. "Sot Edi Rama dhe oborri i tij heshtin për skandalin e radhës, hesht ish-ministri dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë, por ta kenë të qartë se heshtja e tyre nuk

do t'i shpëtojë dot as nga fajësia dhe përgjegjësia që kanë për katastrofën ku po çojnë Shqipërinë. Sot dua të përsëjndes deklaratën e ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në OSBE për gjuhën e tij të drejtëdrejtë në këtë situatë për të cilën ndodhet Sh-

qipëria. LSI ka të njëjtin qëndrim të palëkundur se korrupsioni dhe kriminaliteti ngelen pengesat më të mëdha për zhvillimin e Shqipërisë", deklaroi Kryemadhi. Kjo deklaratë, e cila sipas saj flet me emra të përveçëm dhe vendos gishtin mbi plagë është e kundërta e gjuhës së rrumbullakosur që kemi dëgjuar rëndom për këtë situatë kritike ku krimi dhe droga janë ulur këmbëkryq në qeverisjen e Rilindjes.



Gjoshë Buxheti 2018 ka si qëllim rritimin e situatës ekonomike

Kryetarja e Lëvizjes së Gruas për Integrim, Klajda Gjoshë foli dje për një situatë të rënduar të lidhjes së politikës me krimin. Në një dalje për mediat, Gjoshë tha se këto lidhje kanë prekur edhe financat e familjeve shqiptare. Një ditë pas konventës së gruas së LSI-së, Gjoshë shprehu falënderim për të gjitha gratë që erdhën në atë takim. "Kishte shumë arsye që ajo sallë ishte e mbushur plot dje. E para, sepse duhet t'u jepet fund lidhjeve të politikës me krimin dhe e dyta, sepse situata financiare është kthyer në një dhimbje të madhe për çdo familje shqiptare", tha ish-ministria e Integritimit. Gjoshë tha se edhe shpresa e fundit, që ishte buxheti i 2018-ës, ka për qëllim rritimin e situatës ekonomike. "Shpresa e fundit që mund të mbahej të buxheti i vitit të ardhshëm, i vitit 2018, fatkeqsisht edhe ky buxhet rriton akoma më shumë situatën në familjet tona. Është një buxhet që i shtyn të varfrit drejt varfërisë më ekstreme dhe po detyron shtresën e mesme, por edhe rininë e këtij kombi që të largohet nga Shqipëria", u shpreh Gjoshë.

Qeveria vendos: Punonjësit e shtetit, pushim edhe më 27 nëntor

Qeveria vendosi dje t'u japë edhe një ditë më tepër pushim punonjësve të administratës shtetërore. Kështu, përveç datave të 28 dhe 29 nëntorit që janë festat kombëtare, punonjësit e administratës do të kenë pushim edhe ditën e hënë, datën 27 nëntor, për t'u rikthyer në punë më 30 nëntor. Ky vendim është marrë në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e kryeministrit. Sipas vendimit, dita e punës së datës 27 nëntor 2017 do të zëvendësohet në një nga ditët e pushimit brenda këtij viti. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ballë: Prokuroria të nisë hetimin ndaj Bashës, 1 mln \$ për lobim në SHBA

Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, deklaroi dje se, "kryetari i PD-së, Lulzim Basha ka paguar 1 milion dollarë për lobim në SHBA". Ai i bëri thirrje prokurorisë që të nisë menjëherë hetimet. Ky fakt i rëndë, sipas Ballës, "hedh akuzë për përdorim parash nga burime të paligjshme, nga një parti politike në Shqipëri". "Një total prej 1 milion dollarësh qenka paguar nga Partia Demokratike e Shqipërisë vetëm gjatë vitit 2017. Departamenti Amerikan i Drejtësisë, në kuadër të zbardhjes së kontratave të kompanive të lobimit ka hapur edhe dosjen e transfertave 1 milion dollarëshe të Partisë Demokratike të Shqipërisë, me përgjegjësinë e Lulzim Bashës; një pjesë e tyre të kryera prej një kompanie "off-shore", tha Balla. Deputeti i PS-së kërkoi që Basha të sqarohet se ku i ka gjetur këto shuma marramendëse parash, pse ka përdorur kompani "off-shore" për të bërë pagesa në emër të Partisë Demokratike, si dhe të sqarohet nëse është financuar nga para të pista, nga persona të dyshuar për veprimtari kriminale në gjithë këtë transakcion. "Kjo rëndon tërësisht pozicionin ligjor dhe krijon bazë të qëndrueshme për akuzë për sa i përket fshehjes së deklaramenteve të detyrueshme që Partia Demokratike dhe personit përgjegjës, Lulzim Basha, kanë kundrejt ligjit. Për transparencë të publikut, shpenzimet e Partisë Demokratike për fushatën zgjedhore të 25 qershorit raportohen vetëm 500 mijë dollarë. Ne do t'i shkojmë kësaj dosjeje deri në fund. Të dhënat e deritanishme janë tronditëse për burimet e financimit të një partie politike në Shqipëri. 1 milion dollarë, vetëm në tre muajt! Lulzim Basha duhet të sqarohet menjëherë përgjegjësitë e tij dhe të vihet në dispozicion të drejtësisë", tha Balla.



Kreu i grupit të LSI-së akuzon kryeministrin për humbjet në Arbitrazh Vasili, Ramës: Fol për 2 miliardë eurot, kurseju shqiptarëve një '97 tjetër

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili i kërkoi dje kryeministrit Edi Rama t'u kursejë shqiptarëve një vit tjetër 1997. Në një postim në rrjetin social "Facebook", Vasili u shpreh: "Kryeministër, boll u trembe, fol për 2 miliardë eurot, kursejua shqiptarëve një '97 të dytë! Skandali i 2 miliardë eurove është më i rëndi që mund të imagjinohet. Kryeministri e ka prej kohësh në tavolinë. Kryeministri nuk flet nga frika e madhe për pushtetin e tij, sepse e di mirë që ky skandal i 2 miliardë eurove e rrezon për 24 orë", tha më tej Vasili. Sipas tij, "kryeministri është përgjegjës direkt për disa nga këto gjyqe, pasi i ka frymëzuar e mbështetur personalisht veprimet antiligjore dhe për dëmin kolosal financiar që ka ardhur prej këtyre veprimeve. Skandalin nuk e ka zbuluar opozita, por Avokatura e Shtetit, e cila e ngriti me shumë të drejtë dhe përgjegjshmëri këtë aferë gjigante. Humbja e 2 miliardë eurove është një tragjedi me dimension politik-shoqërore të ngjashme me tragjedinë e vitit '97", theksoi Vasili. "Kryeministri lodhet kot duke u shprehur Të gjithë e dinë që kur të ndodhë kjo tragjedi, kryeministri do të ike dukë i lënë pas zjarrin Shqipërisë, një lloj si ata që në '97, pasi i vunë zjarrin, ikën nga vendi. Shqipëria dhe shqiptarët lënguan për vite të tëra pasojat e '97. Ndaj kryeministri nuk ka asnjë të drejtë që të heshtë më, sepse Shqipëria nuk është pronë e tij. Kryeministër, kursejua Shqipërisë një '97 të dytë", u shpreh Vasili.



Takimi me donatorët, Gjijnuri: Brenda vitit 2018, çdo konsumator me kontratë

Reforma e ujit, familjet pa matës të vetëdeklarojnë deri më 1 shkurt

"Subvencionim" të faturave për shtresat në nevojë

Ornela Manjani

Të gjitha familjet që nuk kanë matës për ujin duhet të vetëdeklarojnë deri më 1 shkurt të vitit të ardhshëm. Deri në fund të vitit 2018 do të përfundojë lidhja e kontratave me çdo abonent. Pas nisjes së fazës së parë të reformës së ujit në zyrat e ujësjellësve, është shënuar një fluks për të formalizuar lidhjet e paligjshme. Deklarata u bë nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjijnuri, gjatë një takimi me donatorët. Ai theksoi edhe një herë objektivin e qeverisë për këtë reformë. "Faza e parë 90-ditore përfundon në 1 shkurt 2018. Gjatë kësaj kohe, më lejoni t'u bëj thirrje qytetarëve të bëjnë vetëdeklarimin e lidhjeve të paligjshme. Objektivi kryesor është që brenda vitit 2018 çdo konsumator të pajiset me një kontratë, të paguajë rregullisht detyrimet", - tha Gjijnuri. Ministri deklaroi se sfida mbetet ulja e nivelit të humbjeve në rrjet, ndërsa nënvizoi se familjet në nevojë do të subvencionohen. "Është marrë angazhimi të subvencionohet minimumi i nevojshëm për këto shtresa, duke mundësuar ofrimin e një shërbimi jetik për qytetarët dhe duke hequr çdo justifikim nga kryetarët e bashkive apo drejtuesit e ujësjellësve, që nxjerrin si shkak mundësinë e ulët ekonomike të qytetarëve", - tha ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Në takimin me donatorët, Gjijnuri kërkoi mbështetjen e tyre nga pikëpamja teknike, asistencë për legjislacionin e ri për ujësjellës-kanalizimet dhe ndihmë në aspektin menaxhial për sistemin e ndërmarrjeve.

SUBVENCIONIMI

"Qeveria shqiptare ka angazhimin maksimal për t'u mundësuar ofrimin e këtij shërbimi shtresave në nevojë. Në këtë kuadër është marrë angazhimi që të subvencionohet nga qeverisja qendrore, minimumi i nevojshëm për këto shtresa, duke mundësuar kështu ofrimin e këtij shërbimi jetik për qytetarët, por edhe duke hequr tashmë çdo justifikim për kryetarët e bashkive, drejtuesit e shoqërive dhe qytetarët për mosformalizimin e këtij sektori", - tha dhe Gjijnuri. Përsa i përket metodologjisë së programimit të investimeve, që prej vitit të ardhshëm buxhetor investimet do të shpërndahen së pari, duke u bazuar në prioritetet dhe metodologjinë e përcaktuar në masterplan, kombinuar kjo edhe me vlerësimin e performancës për secilin shoqëri. Përsa i përket krijimit të shoqërive të qëndrueshme dhe që rikuperojnë kostot, qeveria do të nxisë përdorimin e strategjisë së financimit të sektorit të ujësjellës kanalizimeve, si një instrument për të kuptuar



Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjijnuri, gjatë një takimi me donatorët për reformën e ujit

dorimin e strategjisë së financimit të sektorit të ujësjellës kanalizimeve, si një instrument për të kuptuar

ar nevojat për financim, si në nivel kombëtar, ashtu edhe për secilin bashki, si dhe do të kërkojë që brenda

vitit të ardhshëm secila shoqëri të ketë biznes-planin përkatës 5-vjeçar, i cili do të udhëheqë punën e tyre.

"Problemi i menaxhimit të ujësjellësve mbi të gjitha është një problem menaxhial dhe njerëzor. Kjo është domethënëse, sepse ndodh që në vende të ndryshme të Shqipërisë, në kushte të njëjta, madje edhe me vështirësi teknike shpesh drejtimi profesional ka bërë diferencën dhe këto janë mësimet që nxjerra brenda vendit tonë. Ky është një parim i përgjithshëm, që ne duhet ta aplikojmë kudo. Kudo ku ka një menaxhim profesional dhe certifikim të këtyre stafëve dhe këto ndërmarrje nuk mund të përdoren më për interesa të ngushta politike, suksesi është i garantuar", - tha Gjijnuri.

DEKLARATA

"Është marrë angazhimi të subvencionohet minimumi i nevojshëm për këto shtresa, duke mundësuar ofrimin e një shërbimi jetik për qytetarët dhe duke hequr çdo justifikim nga kryetarët e bashkive apo drejtuesit e ujësjellësve, që nxjerrin si shkak mundësinë e ulët ekonomike të qytetarëve", - tha ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, në kuadër të informimit të bizneseve mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ka bërë një përmbledhje të kuadrit ligjor për të gjithë ata që duan të dinë detyrimin e regjistrimit, furnizimin e mallrave që i nënshtrohen këtij regjimi, si dhe të drejtën e rimbursimit. Referuar njoftimit, Tatimet sqarojnë nga A-ja tek Zh-ja TVSH-në dhe kjo vjen në kushtet kur edhe së fundmi kuadri ligjor ka pësuar ndryshime domethënëse, që lidhen me trajtimin specifik të hoteleve me 5 yje (status special), si dhe ndryshimin e pragut për regjistrimin në TVSH, që ulet në 2 milionë lekë. Tatimet informojnë se Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) është një tatim i përgjithshëm mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve, proporcional me çmimin e tyre, që i ngarkohet në çdo fazë të prodhimit dhe procesit të shpërndarjes çmimit pa tatimin. Tatimit mbi Vlerën e Shtuar i nënshtrohen të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të kryera kundrejt pagesës brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një person i tatueshëm, që vepron si i tillë dhe të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në pjesët përbërëse të tij paraqiten në mënyrë të hollësishme momentet më kyçe të zbatimit të mekanizmit të TVSH-së.

Ndryshimet në skemën e TVSH-së

Tatimet: Bizneset që duhet të regjistrohen

Kështu, ligji jep përcaktime të qarta lidhur me kërkuesmërinë e tatimit, me vendin e furnizimit, qoftë të mallrave, ashtu edhe shërbimeve. Një vend të rëndësishëm së trajtimi i hollësishëm i ndërkombëtarizimit të furnizimeve të mallrave e shërbimeve, parë në kënd-

vështrimin e skemës së funksionimit të TVSH-së. Personat e detyruar që të regjistrohen, që të mbajnë regjistrimet e tyre korrente, që të deklarojnë dhe të paguajnë TVSH-në zënë një hapësirë të konsiderueshme në strukturën e këtij ligji. Përkundër detyrimeve, ligji



paraqet qartë edhe të drejtën e çdo personi të tatueshëm për të përfutur nga rimbursimi i TVSH. Për herë të

parë, ligji trajton edhe skemën të veçantë të regjimeve tatimore të TVSH-së të aplikuar në Shqipëri.

Afati i fundit për "amnistinë" fiskale

Tatimet sqarojnë bizneset si të përfitojnë

Kur ka mbetur vetëm një muaj kohë nga përfundimi i afatit ligjor për fshirjen e detyrimeve tatimore, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, në një material të posaçëm sqaron tatimpaguesit se si mund të përfitojnë. Tatimpaguesit që kanë tepriçës kreditore të TVSH-së ose të njëjtit tjetër përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore, pas kompensimit (zvogëlimit) të tepriçës kreditore deri në masën e tatimit principal të papaguar. Kur tepriçës kreditore nuk mbulon vlerën e plotë të tatimit të papaguar, tatimpaguesi duhet të kryejë pagesën e pjesës së mbetur të tatimit të papaguar, në mënyrë që të përfitojë nga fshirja



e dënimeve administrative. Kompensimi i tepriçës kreditore me detyrimin tatimor të papaguar zbatohet pa kontroll paraprak të tepriçës kreditore nga administrata tatimore. Ligji parashikon ndërprerjen e masave të mbledhjes me forcë nga administrata tatimore për detyrimet tatimore të papaguara që fshihen/shuhën.

TË PËRJASHTUARIT

Tatimpaguesit e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën tatimore, në kuptim të legjislacionit të fushës nuk mund të përfitojnë nga fshirja/falja e detyrimeve tatimore të papaguara. Ndërkohë që për të përfutur nga fshirja e detyrimeve tatimore të papaguara, të cilat janë në

proces ankimimi administrativ ose gjyqësor; tatimpaguesi duhet të heqë dorë nga ankimin administrativ ose gjyqësor në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës administrative kompetente. Bazuar në Ligjin Nr. 33/2017, datë 30.3.2017, të gjithë tatimpaguesit e regjistruar në regjistrin aktiv, pasiv ose të cregjistruar që kanë detyrime tatimore të papaguara ndaj administratës tatimore qendrore e vendore, mund të përfitojnë nga fshirja/falja sipas kushteve të përcaktuara në ligj. Tatimpaguesit e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën tatimore, në kuptim të legjislacionit të fushës, nuk mund të përfitojnë nga fshirja/falja e detyrimeve tatimore të papaguara.

Ministri i Bujqësisë, Niko Peleshi deklaroi se nga subvencionet që buxheti ka dhënë gjithë këto vite për bujqësinë kanë përfitur vetëm një grusht fermerësh. "Është rritur shumë numri i dokumenteve që kërkohen për të përfitur subvencion. Kjo, së bashku me përqindjen shumë të ulët të atyre që përfitojnë i kanë dekurajuar



Ministri në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese

Subvencionet, Niko Peleshi: Fituan vetëm një grusht fermerësh

fermerët. Duhet ta themi vetëm 1 për qind e fermerëve kanë marrë subvencionet", deklaroi Peleshi. Kreu i Bujqësisë tha se qeveria do të ndryshojë skemën e subvencioneve, duke thjeshtuar

procedurat burokratike. "Do t'u kërkohet fermerëve që të aplikojnë për subvencione dhe të plotësojnë me vetëdeklarim një formular. Në bazë të kriterëve do të bëhet përzgjedhja e fituesve

dhe vetëm fituesit do të sjellin dokumentacionin që vërteton deklaratën", shtoi Peleshi. Vitin e ardhshëm, qeveria do të japë 20 milionë euro subvencione për fermerët nga buxheti, por

paralelisht janë edhe 100 milionë euro të tjera nga fondet e BE. Peleshi u bëri thirrje fermerëve të formalizohen për të përfitur nga këto fonde. "Vitin tjetër do të ndryshojë retorika lidhur me financimet. Nuk do të diskutojmë më që s'kemi para për të mbështetur fermerët, por do të diskutojmë si t'i bëjmë fermerët të përthithin para më shumë", u shpreh ai.

Ornela Manjani

Sherri për vetingun tek 'Ekonomia', Braçe: Më duhen 38 mln dollarë. Shehaj: I pangopur

Pronat, Gjonaj: Si do të ndahen 30 milionë dollarë

Ish-pronarët, skema për pagesa të përshpjetuara

Ish-pronarët do të kenë në dispozicion një fond prej 30 milionë dollarësh për vitin e ardhshëm. Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, gjatë raportimit në Komisionin e Ekonomisë ka folur për kompensimin e pronarëve, ku sipas saj janë përdorur mbi 30 milionë dollarë, ndërkohë që ATP ka kompensuar gjatë 2017-ës, 754 subjekte, ku 175 janë kompensuar nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga të ardhurat e ALUIZNI-t. Sipas ministres Gjonaj, për vitin 2018 janë në dispozicion 2.5 miliardë lekë, duke i shtuar shifrën edhe të ardhurat nga ALUIZNI, kusipas saj janë rreth 700 milionë lekë më tepër për kompensimin e pronarëve. "ATP ka kompensuar gjatë 2017-ës, 754 subjektet, ku 175 janë kompensuar nga buxheti i shtetit, ndërsa pjesa tjetër nga të ardhurat e

ALUIZNI-t. Për vitin 2018 janë 2.5 mld lekë, plus të ardhurave që shtohen nga ALUIZNI, pra kemi 700 mln lekë me tepër se viti i kaluar për kompensimin e pronarëve", tha Gjonaj. Pagesat e kompensimit për ish-pronarët do vijnë me dosjet e vitit 1995 dhe ndërkohë pritet vlerësimi financiar për vitin 1996 dhe

1997. Për të përfitur pagesë jashtë radhe në ligjin për pronën parashikohet një skemë, sipas të cilës kur sub-

jekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 1 viti, atëherë ai përfiton 20% të vlerës së kompensimit dhe

heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Ndërsa kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 3 vjetësh, atëherë ai përfiton 30% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Për rastet kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 5 vjetësh, atëherë ai përfiton 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Sipas ligjit, prioritet do të kenë aplikimet që kërkojnë të kompensohen financiarisht brenda 1 viti nga kërkesat për kompensim brenda 3 apo 5 vjetësh.

gun. "Paketa financiare mbështet krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Pavarur të Drejtësisë, duke i konsideruar si zëra në buxhet jo vetëm inspektorët, por edhe infrastrukturën që do t'u nevojitet gjatë vitit 2018, kur do të fillojnë punën. Gjithashtu, garanton Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, strukturat e specializuara antikorruption, SPAK, përfshirë prokurorinë dhe gjykatat e posaçme të dyja niveleve. Mbështet platformën IT, vendosjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore", tha Gjonaj. Gjithashtu, Gjonaj kërkoi që fondi prej 150 mln lekësh, që ishte parashikuar gjatë 2017-ës për ambientet e akomodimit të Kolegjit të Apelit, meqenëse nuk u përdor gjatë këtij viti, t'i kalojë Ministrisë së Drejtësisë për vitin e ardhshëm. Gjatë raportimit të Gjonajt, deputetët e mazhorancës dhe opozitës kanë replikuar ashpër. Debatit është zhvilluar mes kryetarit të Komisionit të Ekonomisë, Erion Braçe dhe deputetit të PD-së, Agron Shehaj në mbledhjen e sotme, ku diskutuohet projekt-buxheti 2018. Pas pyetjes së ministres së Drejtësisë, Etilda Gjonaj, deputeti Shehaj ka kërkuar të flasë më gjatë, por është ndërprerë nga kryetari i komisionit, Erion Braçe, i cili me sa duket e ka cilësuar koment të deputetit. Jo pyetje. Në mbledhje po diskutohet mbi buxhetin e organeve të vetingut, kur deputeti Shehaj ka ndërhyrë duke thënë se këto organe nuk do të jenë të pavarura. Pas ndërprerjes së fjalës, nisi edhe debati i ashpër që gati shkoi me përplasje fizike mes dy deputetëve.



Raporti i INSTAT

Shitjet e biznesit, tendencë e kundërt me rritjen ekonomike

Biznesi shqiptar rriti shitjet me 4.4% për vitin e kaluar. Të dhënat paraprake të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve 2016 tregojnë se norma e rritjes së shitjeve është ulur në raport me rritjen prej 4.7% të vitit 2015. Rritja më e dobët e shitjeve për të dytin vit radhazi është një lloj paradoksi, po të kemi parasysh se rritja ekonomike gjatë viteve të fundit po ndjek një tendencë në përmirësim. Parimisht, do të pritej që për një ekonomi në rritje, volumi i shitjeve të biznesit të ishte gjithashtu në rritje. Por, ndërkohë që rritja ekonomike po përmirësohet me mbi një pikë përqindjeje çdo vit, shitjet e biznesit po rriten me një hap në ngadalësim. Kontributi në rritjen e shitjeve ka ardhur kryesisht nga dega e shërbimeve, që ka kontribuar për 3.7% të rritjes totale të shitjeve, ndërsa prodhuesit e të mirave me 0.7%. Për këtë vit, raporti i shitjeve në ekonominë shqiptare është thelluar edhe më shumë në favor të shërbimeve, ku një ndikim të konsiderueshëm ka pasur kriza e industrisë nxjerrëse. Ndonëse investimet e biznesit u rritën edhe për vitin e kaluar, sërish tendenca është më e dobët krahasuar me vitin 2015. Kështu, rritja e investimeve nga ndërmarrjet për vitin 2016 ishte 6.3%, nga 13.5% që kishte qenë vitin paraardhës. Sipas INSTAT, mbi 42% e investimeve janë kryer në sektorin energjetik, kryesisht në projektet madhore për ndërtimin e veprave të reja. Një trajektore të ngjashme me investimet ka regjistruar edhe punësimi. Numri i të punësuarve është rritur me afro 8%, sërish rritja është ndjeshëm më e ulët krahasuar me nivelin 17.1% të vitit 2015.



ZBARDHET DEBATI BRAÇE-SHEHAJ

- **Agron Shehaj:** Zoti kryetar, unë personalisht nuk kam shumë eksperiencë në politike dhe në komisione, por këtë sjellje që shoh nga ana juaj në këtë komision...
- **Erjon Braçe:** Faleminderit shumë, mua nuk më vlerësoni dot sjelljen. Faleminderit, nuk ka fjalë për... Nuk jemi mbledhur këtu për mua. Më vjen keq.
- **Jorida Tabaku:** Ka të drejtën e fjalës.
- **Erjon Braçe:** Thoni ç'a të doni se s'më intereson fare.
- **Jorida Tabaku:** E kam për procedurë.
- **Erjon Braçe:** Zonja Tabaku, edukatë morale nuk duroj dot unë.
- **Jorida Tabaku:** E kam për procedurë.
- **Erjon Braçe:** Më vjen keq! Të vijë ministri tjetër.
- **Jorida Tabaku:** Në qoftë se do ta vazhdojsh mbledhjen vetëm... vazhdoje.
- **Erjon Braçe:** Si ta keni, pa asnjë problem fare.
- **Jorida Tabaku:** Zoti kryetar, kur kërkohet fjalën anëtarët e komisionit, mund të kenë pyetje edhe më të gjata.
- **Erjon Braçe:** Jo, pyetje jo. Pyetjet e gjata nuk janë komente.
- **Jorida Tabaku:** Ashtu siç i kanë pyetjet, nëse s'marrin përgjigje...
- **Erjon Braçe:** Zotëria e tha vetë "Ky ishte opinionin im për çfarë të ministria". Më vjen keq. Pse do ta bësh opinionin pyetje?! S'ka pikë kuptimi. Ndryshe s'i bie radha asnjërit në këtë komision.
- **Shehaj** (pa mikrofon, në këmbë): Zoti kryetar jeni të pangopur. Nuk të mjaftuan 27 vjet?!
➤ **Erjon Braçe:** Më duhen 38 mln dollarë.
- **Agron Shehaj:** Të duhen 38 mln dollarë ë... I pangopur.
- (Shehaj në këmbë dhe i afrohet Braçes)
- **Erjon Braçe:** Hajde, hajde (me shenjë që të largohet).
- Pas pak hyn gardisti, largon Shehajin. Vijojnë replikat në distancë. Shehaj afrohet sërish dhe pas 2 sekondash, Braçe çohet më këmbë dhe i afrohet deputetit të PD-së, duke i thënë disa herë të ikë. Madje, dëgjohej edhe një fjalor banal.
- **Erjon Braçe:** Ik tani, ik tani! Ik se s'më ha k***. Ik se e mora vesh.
- **Jorida Tabaku:** Zoti Braçe... (Shehajin e tërheq gardisti. Braçe e tërheq deputetin i PS-së, Anastas Angjeli).



Gjakata e Durrësit

Policia e arrestoi në gjumë, tha se e kapi në flagrancë

Skandali, Gjykata e Durrësit liron Kristian Preçin

DURRËS - Gjykata e Durrësit ka vendosur dje lirinë e shtetasit Kristian Preçi dhe pushimin e çështjes. Rasti i Preçit u bë publik nga emisioni investigativ "Boom", duke përfshirë të gjitha hallkat e shtetit, që nga policia, prokuroria, gjykata. Ai u arrestua në shtëpinë e tij pas një deklarate të një shteta-

seje, sipas së cilës ai i kishte vjedhur celularin. Preçi arrestohet dhe madje në procesverbal, megjithëse gjatë kontrollit nuk iu gjet asgjë dhe arrestimi u bë në gjumë, u shënuar se ishte kapur në flagrancë. Emisioni investigativ "Boom" është i interesuar për rastin, duke nxjerrë në dritë mënyrat se si ve-

projnë dhe gati bashkëpunojnë hallkat e drejtësisë edhe për raste të tilla flagrante. Prokurori që pranon se për shkak të vjedhjeve të shumta, bëhen edhe shembuj. Gjykata që vendoste ta linte në burg, parësisht se provat e gish-tërinjve kishin rezultuar negative dhe madje telefoni

i ishte gjetur dikujt tjetër. Policia që shoqëronte familjarët e verbër të Kristianit, pse kishin protestuar për vendimin karshi tij. I gjithë ky kalvar, i cili vazhonte prej katër muajsh, mori fund dje me vendimin e Gjykatës së Durrësit që vendosi pushimin e çështjes dhe kthimin e Preçit në liri. Një e drejtë e kthyer në vend, por pas katër muajsh padrejtësie, që normalisht duhet t'i venë në lëvizje të gjitha strukturat e drejtësisë në linjë vertikale.

Çifti Metushi i siguronte të ardhurat përmes rritjes së gjelave

Kavajë, krimi në familje, burri ther me thikë gruan, nënë e pesë fëmijëve

Policia: Ende nuk dihen rrethanat e sherrit

KAVAJË

Dje rreth orës 11:00 policia e Kavajës u njoftua për krim në familje. Ngjarja e rëndë ndodhi në fshatin Karpen të Kavajës, ku një grua u vra me thikë nga bashkëshorti i saj, 58-vjeçari Sami Metushi vrau me thikë brenda në banesë bashkëshorten e tij, Sose Metushi, 55 vjeçe. Në banesë në momentin e krimit e ndodhjet një nga djemtë e çiftit, por nuk mundi të shmangte tragjedinë. Mësohet se bashkëshortët ishin prindër të pesë fëmijëve, dy djem dhe tri vajza.

HETIMET

Sipas hetimeve para-prake, bëhet me dije se ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta, pas shërreve të vazhdueshme mes tyre, por ende nuk dihen rrethanat se si ka ndodhur konflikti. Të afërmit e tyre, që kanë hapur tashmë dyert e mortit thonë se burrë e grua grindeshin shpesh dhe shkak ishin gjithnjë mosmarrëveshjet ekonomike, shkruan "Ballkanwb". Mësohet se dy vajzat e çiftit Metushi, pas divorcit ishin kthyer në

EKONOMIA

Fqinjët tregojnë se burrë e grua merreshin me punë fshati, me rritjen e gjelave të detit dhe serave. Bashkëshortët Metushi i siguronin të ardhurat nga bujqësia e blegtoria, përveç rritjes së gjelave të detit, kishin edhe një serë afër banesës, me fitimet e së cilës, përballonin jetesën.



Banesa ku ndodhi krimi



Policia në vendin e ngjarjes

shtëpinë e prindërve. Çifti Sami dhe Sose Metushi kishin disa vite që ishin vendosur në fshatin Karpen, pas shpërnguljes nga vendlindja e tyre, Elbasani. Fqinjët tregojnë se burrë e grua merreshin me punë fshati, me rritjen e gjelave të detit dhe serave. Bashkëshortët Me-

tushi i siguronin të ardhurat nga bujqësia e blegtoria, përveç rritjes së gjelave të detit, kishin edhe një serë afër banesës, me fitimet e së cilës përballonin jetesën. Ndërsa dje burimet policore bënë me dije se shkak për sherrin është bërë një zënkë e momentit. Ndonëse 55-

vjeçares Sose Metushi iu dhaindhim e menjëherëshme, ajo s'mundi të mbijetonte. Menjëherë pas krimit të rëndë, shërbimet e policisë bënë të mundur arrestimin e shtetasit S.M., i cili u dërgua në komisariat. Pas krimit, autori nuk tentoi të largohet, por priti uniformat blu.

Ndërkohë trupi i pajetë i 55-vjeçares u dërgua në morg për t'u nënshtruar ekspertizës mjeko-ligjore. Pas kësaj, pritet të tërhiqet nga familjarët për t'u përcjellë për në banesën e fundit. Sakaq grupi hetimor po vijon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Gjenden pas dy ditësh adoleshentet e zhdukura në Tiranë

TIRANE - Dy vajzat e mitura, të cilat u shpallën të zhdukura nga familjarët e tyre tri ditë më parë janë gjetur nga policia. Adolleshentet nga Paskuqani, të cilat ishin shoqe me njëra-tjetrën, A.O dhe E.P të dyja 16 vjeçe, janë gjetur nga policia dhe u janë dorëzuar familjarëve. Ato kanë deklaruar në polici se ishin larguar, pasi vëllai 23-vjeçar i E.P. kishte ushtruar dhunë psikologjike. Më herët shoqja e dy adoleshenteve ka thënë në polici se i ka dëgjuar vajzat të flasin për një udhëtim drejt Kosovës, por pa dhënë detaje se kush ishin personat që do shqëronin minorenat. Ka qenë një denoncim në polici nga A.O. dhe E.P., vëllai dhe babai i vajzave, të cilët kanë deklaruar se ato nuk janë kthyer në shtëpi pas shkollës, ditën e hënë. Vajzat nuk e kanë përfunduar mësimin, por e kanë braktisur atë që në orët e para të paradites të së hënës duke humbur gjurmët.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,046,800 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkeje me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 19 Dhjetor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve UPS të dhomave të serverave të Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2,700,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkeje me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve UPS të dhomave të serverave të Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 18 Dhjetor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Dhurata e Ramiz Saraçi në "News 24": Ka qenë i droguar kur ka bërë krimin

Vrau taksistin, prindërit e autorit: Mos e dënoni djalin me burg përjetë "Ka bërë aksident, e la me pasoja në kokë"

TIRANË

Cështja e taksistit Idriz Kariqi, i cili u mor peng dhe më pas u vra për 1900 lekë në fshatin Greth të Kavajës, është rikthyer dje në emisionin "Me zemër të hapur" në "News 24". Ndonëse autori, Musa Saraçi është dënuar nga gjykata e këtij rrethi me burg përjetë, prindërit e tij, Dhurata dhe Ramiz Saraçi apelojnë për gjykim të shkurtuar dhe lehtësim të masës së dënimit për djalin e tyre. Nëna e 25-vjeçarit tregoi në studion e emisionit se gjatë shqyrtimit gjyqësor, avokati mbrojtës pretendoi se ai kishte probleme të çrregullimit mendor. Dhurata Saraçi tha se djali i saj kishte bërë një aksident që e kishte lënë me pasoja në kokë, ndërkohë që kartela mjekësore është në spitalin e Durrësit. Në rrëfimin e saj, ajo tregoi se i biri ditën e krimit ishte nën efektin e lëndëve narkotike dhe nuk mbante mend asgjë nga ajo se çfarë kishte ndodhur.



Autori i krimit, Musa Saraçi

Taksisti i vrarë, Idriz Kariqi

filiste me mua më shumë. Më tha: Mami kam qenë i pavetëdijshëm. Kam qenë i droguar", - u shpreh Dhurata Saraçi. Por, pretendimi i familjarëve u rrëzua nga akti i ekspertimit. Aktual-

isht çështja është në Gjykatën e Apelit, ndërsa prindërit kërkojnë gjykim të shkurtuar.

VRASJA E TAKSISTIT
Ngjarja e rëndë ku mbeti i vrarë 65-vjeçari Idriz Kari-

KARTELA MJEKËSORE

Dhurata Saraçi tha se djali i saj kishte bërë një aksident që e kishte lënë me pasoja në kokë, ndërkohë që kartela mjekësore është në spitalin e Durrësit. Në rrëfimin e saj, ajo tregoi se i biri ditën e krimit ishte nën efektin e lëndëve narkotike dhe nuk mbante mend asgjë nga çfarë kishte ndodhur.



Prindërit e Musa Saraçi në "News 24"

qi ndodhi më 14 dhjetor të vitit 2016. Musa Saraçi mori peng dhe më pas e vrau taksistin Kariqi, ndërsa automjetin e tij e shiti në një varrezë makinash. Referuar dosjes së Prokurorisë së Kavajës, nga hetimet ka rezultuar se: "I pandehuri Saraçi, paraditen e datës 14.12.2016 ka marrë si shërbim taksi mjedin e drejtuar nga viktima Kariqi, në vendin pranë Spitalit të Kavajës. I pandehuri gjatë natës së mëparshme kishte qenë duke luajtur në lojëra fati dhe kishte shpenzuar paratë që i kishte marrë pa dajeninë e familjes së tij. Që në momentin që ka hipur në taksi, ai ka pasur qëllim për të marrë paratë e taksistit.

Pranë fshatit Greth, ai i ka kërkuar taksistit të ndalojë makinën dhe nën kërcënimin e një thike i ka kërkuar atij që t'i japë paratë që kishte me vete. Taksisti Kariqi ka nxjerrë paratë që kishte me vete, rreth 1900 lekë të reja, por këto kanë qenë të pamjaf-tueshme për autorin, i cili e ka goditur disa herë me thikë duke e lënë të vdekur në vend. Më pas, autori ka marrë makinën e viktimit dhe ka ecur disa minuta, derisa mjedi është rrezuar në një kanal dhe është dëmtuar. Duke qenë se automjeti nuk mund të lëvizte, i pandehuri ka telefonuar një të njohurin e tij që posedon një servis makinash, të cilit i ka thënë se kishte një makinë të prishur dhe donte ta shiste për skrap. I pandehuri Saraçi ka shkruar në këmbë deri tek servisi i të njohurit të tij dhe kanë bërë "Pazar" që makinën ta shiste për 27 mijë lekë të reja. Pasi ka marrë paratë, autori i krimit është larguar dhe është arrestuar pas dy ditësh, në vijim të veprimeve procedurale hetimore", sqaron prokuroria.



U kap me kokainë në lokal, arrestohet i riu nga Tirana

LEZHË - Një 24-vjeçar nga Tirana është arrestuar nga policia e Lezhës, pasi i është gjetur një sasi kokaine. Bëhet fjalë për 24-vjeçarin Marsen Hysa, i cili u kap në flagrancë gjatë operacionit të koduar "Lisus". Burime zyrtare nga blutë e Lezhës bënë me dije se i riu u prangos, pasi gjatë kontrollit fizik të ush-truar ndaj tij në një lokal në Lezhë, i është gjetur e fshehur në robra një sasi prej 198 gr lëndë narkotike e llojit "Kokainë", e paketuar në 2 qese plastike. Ndërkaq, vijojnë hetimet për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale. Materialet procedurale në ngarkim të Marsen Hysës i kaluan për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për veprën penale: "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike".

Maskat terrorizojnë e grabisin pasagjerët, djegin furgonin

SHKODËR - Terror në Dukagjin të Shkodrës. Mësohet se persona ende të pidentifikuar i kanë bërë pritë një furgonin dhe pasi e kanë ndaluar, kanë grabitur pasagjerët që udhëtonin me të. Edhe pse u kanë marrë paratë dhe sendet me vlerë pasagjerëve, grabitësit nuk janë mjaftuar me kaq. Ata i kanë vënë zjarrin furgonit për të fshehur gjurmët. Sapo janë njoftuar, forcat e policisë kanë mbërritur në vendngjarje dhe kanë marrë në pyetje pasagjerët dhe drejtuesin e mjetit. Sakaq po punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve të grabitjes.



SHKURT

Sherr me thika mes dy nxënësve në Vlorë, plagoset 16-vjeçari

VLORË - Sherrri mes dy nxënësve në Vlorë ka përfunduar me plagosjen e njërit prej tyre. Burime nga policia lokale pohuan se ngjarja ndodhi mesditën e djeshme në lagjen "1 Maji" të këtij qyteti. Mësohet se 14-vjeçari A.N. ka goditur me thikë në bark 16-vjeçarin V.C. për një shikim. Sipas bluve, autori i ngjarjes i ka thënë nxënësit tjetër më të madh se "pse më sheh" dhe më pas ka nisur sherrin me tyre. 16-vjeçari është dërguar në spitalin e Vlorës, ku dhe i është dhënë ndihma e parë mjekësore. Ndërkaq, policia ka shoqëruar 14-vjeçarin për zbardhjen e plotë të ngjarjes. Po të njëjtat burime thanë se autori dhe i plagosuri janë nxënës të shkollave të ndryshme ("Jani Minga" dhe "Marigo Posio").

Shpërthim me eksploziv për herë të dytë në një biznes në Krujë

KRUJË - Një shpërthim me eksploziv ka ndodhur mëngjesin e djeshëm në një biznes në Krujë. Sipas burimeve nga policia lokale, shpërthimi ka ndodhur rreth orës 01:05 në një dyqan në pronësi të shtetasit Gëzim Meta, në fshatin Zezë të njësies administrative Nikël (Krujë). Fatmirësisht nuk ka pasur persona të lënduar, por vetëm dëme të mëdha materiale. Policia ka shkruar në vendin e ngjarjes dhe ka nisur hetimet, ndërsa ka marrë në pyetje edhe pronarin e dyqanit për të zbuluar nëse ka konflikte të mundshme që mund të kenë qenë në këtë akt kriminal. Ndërkaq, mësohet se kjo është hera e dytë që këtij biznesi i vihet eksploziv. Materialet në lidhje me këtë ngjarjeje i janë përcjellë për hetime të mëtejshme prokurorisë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

PASURINË NR. 2/963-ND+1-43 , E LLOJIT "APARTAMENT", VOLUMI 55 , FAQJE 73. ZONA KADASTRALE 8513 , ME SIPËRFAQJE 67,81 M2 , NË ADRESËN : RRUGA "K. KËRTUSA", SHKALLA 1 , KATI 7 , DURRËS , NË PRONËSI TË SHITËTASVE : Z. LUTFI GJYZELI DHE Z.NJ. ENKELLEJDA GJYZELI

ÇMIMI 4.000.000 LEKË , Data e zhvillimit të ankandit do jetë 15.12.2017 .

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE "ILIA ELEZË"
Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Pallati "GORA", Kulla 1, Kati 2, Tirane.
Cel:0684026666 ; 0693262866

SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- 1- **Apartment** me sip. 147 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8270, Numri Pasurise 3/40+1-16. , Volum.42, Faqe.56. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **148.176 Euro.**
- 2- **Garazh, Nr.1** me sip. 520 m²,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G1, vol.18, faqe.72. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **445.536 Euro.**
- 3- **Njesi** me sip. 50 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N2, vol.18, faqe.76. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha.Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **120.960 Euro.**
- 4- **Garazh N.2** me sip. 50 m².Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane.ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G2, vol.18, faqe.73. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha.Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **42.840 Euro.**
- 5- **Garazh N.3** me sip.570 m².Vendndodhja:Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-G3, vol.18, faqe.74. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **488.376 Euro.**
- 6- **Apartment** me sip. 402.9 m²,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane,ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise 3/241+1-1, Volum.18, Faqe.78. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **731.022 Euro.**
- 7- **Njesi** me sip. 310 m²,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane,ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N1, vol.18, faqe.75. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **750.920 Euro.**
- 8- **Njesi** me sip. 364.7 m²,Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane,ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurise: 3/241-N3, vol.18, faqe.77. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin do te filloje ankandi III është **827.139 Euro.**

Ankandi per te gjitha pasuritë e sipërcituara do te zhvillohet date **05.12.2017 ora 16.00** në zyrat e shoqerise EPSA shpk te ndodhura ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane.

KESHILLI BASHKIAK VENDIMET

MBLEDHJA/ Ja vendimet e rëndësishme që u miratuan, Veliaj propozime për të ardhmen

Këshilli bashkiak, pse u përplasën PS, PD e LSI

Cilat janë shtresat sociale që do të përfitojnë

Voltiza Duro

Gjatë mbledhjes së këshillit bashkiak të zhvilluar ditën e djeshme janë miratuar disa vendime të rëndësishme që do t'u vijjnë në ndihmë shtresave sociale dhe nxënësve. Por jo të pakta kanë qenë dhe reagimet e debatet gjatë mbledhjes, ku në seancën e dytë anëtarët e Partisë Demokratike nuk morën pjesë. Ky vendim për të braktisur mbledhjen nga ana e PD-së erdhi pasi sipas tyre, grupi i mazhorancës po tentonte të impononte dy vendime, për të cilat vetëm anëtarët e PS-së ishin në dijeni. Ndërkaq, gjatë mbledhjes u vendos që nga viti 2018 do vihet në jetë një projekt pilot, në mënyrë që nxënësit t'i bëjnë detyrat e shtëpisë në shkollë. Gjithashtu, një tjetër vendim i marrë lidhet me trajtimin me ndihmë ekonomike për disa kategori të caktuara, të cilat nuk e kanë përfituar më parë. Ndërkaq, kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj theksoi se do të rriten edhe pagat e shërbimit zjarrfikës në masën 1-2%. Me polemika të forta u shoqërua edhe miratimi i projektit për mbjelljen e pishave në autostradën Tiranë-Durrës, në të cilin do të investohen 2.5 milionë euro. Në mbledhjen e djeshme u miratua edhe vendimi mbi shtimin e punonjësve të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve me 46 punonjës të rinj, duke e çuar numrin total në 717 vetë. Kjo shtesë e numrit të punonjësve vjen pasi ka pasur një kërkesë të lartë për frekuencimin e çerdheve dhe kopshteve publike. Kryebashkiaku gjithashtu bëri me dije për këshillin edhe dy propozime, që janë në fazë diskutimi e që priten të prezantohen për miratim në mbledhjet e ardhshme. Vendimi i parë ka të bëjë me krijimin e një Qendre Kulturorë Shqiptaro-Hebraike, e cila mund të ngrihet tek Teatri i Kukul-



Mbledhja e Këshillit Bashkiak të Tiranës

MIRATIMI

Në mbledhjen e djeshme u miratua edhe vendimi mbi shtimin e punonjësve të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve me 46 punonjës të rinj, duke e çuar numrin total në 717 vetë.

Mundësi arsimit për komunitetin rom e egjiptian

Drekë dhe detyra shtëpie, katër shkollat që e përfitojnë

Sipas vendimit të marrë në mbledhjen e këshillit bashkiak, detyrat e shtëpisë nga viti 2018 do të bëhen në shkollë, duke i ardhur në ndihmë fëmijëve, veçanërisht atyre të komunitetit rom e egjiptian. Nëpërmjet një projekti pilot, i cili do të zbatohet në 4 shkollë 9-vjeçare në kryeqytet, nxënësit do të kenë mundësi që pas procesit mësimor, të bëjnë detyrat e shtëpisë në ambientet e shkollës deri në orën 17:00. Sipas vendimit, fillimisht do të përfitojnë 3000 fëmijë të moshës 6-15 vjeç, që ndjekin shkollat ku do zbatohet projekti, të cilët do konsumojnë ushqimin, do zhvillojnë aktivitete argëtuese dhe më pas do rikthehen në klasë për të bërë detyrat e shtëpisë. Ndërkohë, ushqimi do financohet 100% nga Bashkia Tiranë për të gjithë nxënësit që vijjnë nga familjet, të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike. "Projekti mundëson që fëmijet e shkollave periferike, në komunitete me popullsi rome, egjiptiane, pra komunitete që janë në vështirësi ekonomike, të vazhdojnë të

rrinin në mësim në grupe speciale, t'u ofrohet edhe dreka në shkollë. Të kenë mundësi që me një mentor të bëjnë detyrat e sh-



tëpisë", - tha kryebashkiaku Veliaj. Shkollat 9-vjeçare të përfshira në këtë projekt janë: "Ardian Klosi", "Betim Muço", "Hasan Tahsin" dhe shkollë "E kuqe".

lave, pas një rikonstruksioni dhe zgjerimi të ambienteve. Ndërsa propozimi i dytë parashikon ndërtimin e një teatri të ri kombëtar. Këshilli bashkiak miratoi edhe vendimin për "Miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në

qytetin e Tiranës", për të cilin kreu i këshilltarëve të PD, Kreshnik Çollaku, pas largimit nga salla me pretendimin se po diskutoheshin çështje jashtë rendit të ditës, u shpreh se ky projektvendim është në favor të ndonjë biznesi taksish me të cilin është lidhur mar-

rëveshje. "Një nga këto projektvendime është aferë e pastër, një shërbim dhe favorizim që i bëhet një biznesi taksish në kryeqytet në kundërshtim dhe në dhumim me normat normale të konkurrencës dhe respektit të bizneseve të tjera", - u shpreh Çollaku.



Vendimi hyn në fuqi në mars

Rriten pagat e shërbimit zjarrfikës me 1-2%

Punonjësit e shërbimit zjarrfikës do të përfitojnë një rritje page 2 dhe 1% për kategorinë e parë dhe të dytë. Ky ishte një tjetër vendim i marrë në mbledhjen e djeshme të këshillit bashkiak, sipas të cilit do të përfitojnë të gjithë punonjësit e sektorit të mbështetjes e logistikës në Drejtorinë e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin. Ky vendim vjen në kuadër të ndryshimeve në legjislacionin e pagave, si dhe të rritjes së nivelit të pagave në nivel qendror dhe vendor. Sipas propozimit të Erion Veliaj, shtesa për vjetërsi në punë për kategorinë I të jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe të llogaritet mbi pagën e grupit, ndërsa shtesa për vjetërsi në punë për kategorinë II të jepet në masën 1% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe të llogaritet mbi pagën bazë. Ndërkohë, të gjitha kategoritë që përfitojnë nga ky vendim do ta përfitojnë rritjen që nga 1 marsi i këtij viti.



Gjithashtu, kryebashkiaku Veliaj theksoi se buxheti i Bashkisë së Tiranës vjen në masë 15% më të lartë se ai aktual dhe bëri me dije se do të bëhen investime edhe në zonat periferike, peri-urbane dhe rurale të Tiranës, duke synuar që brenda vitit 2019 të çohet urbanizimi i plotë kudo ku banojnë qytetarë të Tiranës. Ai tha se vetëm në këtë vit janë rreth 200 rrugë të reja në Tiranë. "Kemi pasur një dyvjeçar të ngjeshur, sidomos me punët nëpër blloqe pallatesh. Kemi pasur 200 ndërhyrje në vit, praktikisht thuajse çdo ditë pune ka një ndërhyrje. Kështu që do të sjellim në këshill një paketë të re me rreth 200 ndërhyrje në Tiranë dhe po të mbajmë këtë ritëm, deri në fund të mandatit thuajse do kemi prekur çdo bllok dhe çdo lagje. Fokusin më të madh në dy buxhetet e ardhshme do ta kemi kryesisht në zonat periferike dhe peri-urbane", u shpreh Veliaj

Njoftim për shitje me ankand
 Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin për pasurinë e dëbitorit V Gjikas, P Gjikas
 Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:
 - "Apartamenti" me numër pasurie 31/202+1-6 faqe 160 Vll 44 , në ZK 8602 me sipërfaqe 63.19 m² në Vlorë
 Ankand: i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 32.880 Euro
 Ankand do të zhvillohet datë 07.12.2017 orën 15:00, selin e shoqërisë "pall Gora" Bulv "Gj. Fishta" Kulla 3, Tiranë Ofruesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com



Gjatë mbledhjes së këshillit bashkiak të Tiranës



Ja kategoritë që e përfitojnë ndihmë ekonomike për familjet në nevojë

Me tej, këshilli bashkiak në lidhje me trajtimin me ndihmë ekonomike të disa familjeve miratoi edhe vendimin "Për miratimin e familjeve përfituese dhe fondit nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind me fondet e buxhetit vendor për periudhën 1-30 nëntor 2017". Kategoritë që do të marrin këtë ndihmë nga fondi i bashkisë janë kryesisht kryefamiljare të divorcuara me shumë fëmijë, kryefamiljare të veja, pa punë, gratë mbi 55 vjeç, burrat mbi 60 vjeç që jetojnë vetëm e familjet me fëmijë të vegjël. Një tjetër vendim i rëndësishëm i miratuar gjatë mbledhjes së sotme të këshillit bashkiak ishte edhe ai "Për një shtesë në numrin e punonjësve të qendrës ekonomike të zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve". Ky vendim parashikon shtimin e punonjësve të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve me 46 punonjës të rinj, duke e çuar numrin total në 717 vetë. Kjo shtesë vjen si rrjedhojë e kërkesës së lartë për frekuentimin e çerdhëve dhe kopshteve publike. Këshilli miratoi edhe vendimin "Për disa ndryshime në vendimin nr. 84, datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017". Sipas këtij vendimi, do të bëhet një rishpërndarje e fondit të investimeve dhe shpenzimeve korrente.

SHPLLAJJE ANKANDI

Shoqëria Përmbartore "Enforcement Group" sh.p.k. shpall ankandin e parë për pasurinë e palaujtshme të llojit Ndërfesë, me Nr. 213/33-ND, volumi 17, faqe 150, ZK 3976, me sipërfaqe 240.50 m² çdo kat, vitë 4 katëshe, adresa e pasurisë Shkozë, Tiranë, në pronësi të Remzi Adli Muça. Çmimi me të cilën do të kasuri në ankandin e parë është 60,028,800 (gjashtëdhjetë milion e njëzet e tetë mijë e tetëqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientin e Shoqërisë Përmbartore "Enforcement Group" sh.p.k. në adresën Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 1, Pallatit e Shoqërisë "Gora", Kati 3, Ap. 14, Tiranë në datën 30.11.2017, ora 16.00. Për kontakt: Cel: 0692687566; email: enforcementgroup2014@gmail.com

Dy këshilltarë të opozitës votuan "pro" mbjelljes së pishave

Veliaj shkarkon 4 administratorë të LSI-së, refuzuan projektet e bashkisë

Emërohen 4 drejtuesit e rinj të njësisë, Pullazi te 2

Katër administratorët e LSI-së në kryeqytet janë shkarkuar. Burime nga Bashkia e Tiranës bënë të ditur se kryebashkiaku Erion Veliaj ka firmosur dje lirimim nga detyra të administratorit të njësisë nr. 2 Elez Gjoza, administratorin e njësisë nr. 11, Gentian Arapi, administratorin e njësisë nr. 8 Erjon Xhafa si dhe kreun e njësisë administrative Bërzhitë, Refik Velia. Ky vendim vjen pas refuzimit të LSI për të mbështetur projektet e Bashkisë së Tiranës. Kryetari i bashkisë, Erion Veliaj mësohet se ka falënderuar administratorët për kontributin e tyre 2-vjeçar në bashki. Pas shkarkimit të 4 administratorëve, Veliaj emëroi 4 emrat e rinj. Kështu në njësinë nr:2 do të jetë Florian Pullazi, në njësinë nr:8 Bujar Xhafa, në njësinë nr:11, Jorida Doku dhe në Bërzhitë u emërua Alban Shaba. Ndërkohë, pro vendimit për të mbjellë pisha në vend të palmave në autostradë votuan dje edhe dy anëtarë të këshillit që i përkasin LSI-së dhe tjetrit PR-së. Naim Halili i LSI-së mësohet të jetë shprehur se "kryetari i bashkisë po punon dhe nuk dua të hyj në histori si dikush që bllokoi punën në Tiranë. Për sa kohë që do punoj, do vazhdoj ta mbështes me votë në këshill", mësohet të jetë shprehur Halili. Anëtarit tjetër i këshillit që i përket PR-së ishte Ferdinand Papadhimas, i cili gjithashtu mbështeti këtë projekt. Ndërkohë Veliaj ka shprehur mirënjohjen për të dy këta këshilltarë të opozitës që votuan pro për qytetin, mbi partitë. Ky vendim i Veliajt vjen edhe pas prishjes së aleancës mes PS-së me LSI-në. Pas dorëheqjes së nënkryetares së Bashkisë së Tiranës, Brunilda Paskali, vjen edhe largimi i 4 administratorëve të tjerë që i përkasin LSI-së, që tashmë është në opozitë dhe ka shpallur hapur aleancën me Partinë Demokratike. Një rrjedhje e tillë votash në këshillin bashkiak ndodhi pak muaj më parë, kur dy këshilltarë të LSI-së votuan pro rritjes së



Kryebashkiaku Erion Veliaj

çmimit të ujit dhe për këtë, ata u zëvendësuan. Vendimi për rritjen e çmimit të ujit është marrë me 31 vota, dy prej të cilëve të LSI, Agim Kraja dhe Genta Mezzini. Vetëm një ditë pas miratimit të vendimit për rritjen e çmimit të ujit në Tiranë, nënkryetaria e bashkisë, Brunilda Paskali që gjithashtu i përkiste LSI-së dha dorëheqjen nga detyra. Në deklaratën për mediat, ajo nënvizoi se LSI do të jetë në opozitë. "Misioni opozitë i LSI më obligon në aktin e dorëheqjes si dëshmi seriozi-

teti, detyrimi dhe përkushtimi krah qytetarëve, që me verdiktin e tyre i kanë besuar LSI përmbushjen e këtij misioni të rëndësishëm", argumentoi Paskali. Ndërkohë, kryetari i bashkisë, Erion Veliaj, në një postim në "Twitter" shprehu vlerësim për Paskalin. "Ishte kënaqësi të kisha në skuadër Brunilda Paskalin këto 2 vite! Mirënjohje për kontributin e përkushtimin për Tiranën tonë! Mbarësi më tej!", u shpreh Veliaj. Pas kësaj dorëheqjeje, Veliaj shkarkoi atëherë nga detyra drejtorin

EMËROHEN

Njësia nr. 2 Florian Pullazi Njësia nr. 8 Bujar Xhafa Njësia nr. 11 në Laprakë, Jorida Doku Në Bërzhitë, Alban Shaba

U SHKARKUAN

Njësia nr. 2 Elez Gjoza Njësia nr. 8 Erjon Xhafa, Njësia nr. 11 në Laprakë, Gentian Arapi Në Bërzhitë Refik Velia

e ndërmarrjes tre Tiranë, Artjon Çauhillari; drejtorin e Qendrës Sociale Shkozë, Kajame Guri si dhe administratorin e Farkës, Gazmend Kullli. Të tre kanë qenë emërimet të LSI-së, e cila kishte ndarë edhe pushtetin në Bashkinë e Tiranës me PS-në, në kohën që të dyja ishin në bashkëqeverisje. Nuk dihet nëse do të ketë masë për këshilltarin tëjetë të LSI-së që votoi dje projektin e Veliajt së bashku me këshilltarët e mazhorancës.

PD nuk është e pranishme, LSI nuk e voton vendimin

Miratohet fondi 2.5 milionë euro për mbjelljen e pishave, debate në këshill

Gjithashtu, Këshilli Bashkiak i Tiranës miratoi projektin për mbjelljen e pishave në autostradën Tiranë-Durrës. Këshilltarët e Partisë Demokratike u larguan përpara fillimit të votimit për rendin e ditës, në një kohë që ky projekt u miratua me 31 vota pro. Nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, Arbjan Mazniku tha se palmat e tharra do të zëvendësohen me mbjelljen e pishave të buta. Por, anëtarët e LSI në këshillin bashkiak nuk e votuan vendimin, pasi sipas tyre, ky investim 2.5 milionë euro mund të shkonte për punët më të rëndësishme të kryeqytetit. Pas largimit nga



salla ku po votoheshin çështje jashtë rendit të ditës, kreu i këshilltarëve të PD në Këshillin Bashkiak të Tiranës, Kreshnik Çollaku, u shpreh se historia e palmave është një aferë e pastër korupsioni dhe një aferë e rëndë për xhepat e qytetarëve. Sipas tij, qytetarët e Tiranës duhet të dinë se kosto e një palme

ka qenë mbi 5 mijë euro dhe për më tepër këto palma u thanë. "Vetëm një pishë kushton 5 milionë lekë. Imaginoni se sa vakte ushqimore për fëmijët, sa shkolle do të ishin ndërtuar apo rehabilituar në rast se këtyre oligarkëve dhe këtyre njerzëve totalisht pa asnjë lloj shenje përgjegjësie në interes të qytetarëve, nuk do t'i kishin rezistuar tundimit për të vjedhur e grabitur", - u shpreh Çollaku. Më tej, ai theksoi se ky vendim është një absurditet i radhës, pasi nga taksat e qytetarëve të Tiranës po shkulan palma e po ngulen pisha, fondi për të cilat do të jetë plot 2.5 milionë euro.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 04.12.2017 ne oren 16.00 ne zyrën e permbartuesit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhje, Njesia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se palaujtshme te llojit "Apartament" me sip.68 m², me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjia 11 Shtatori, pallati 9, shkalla 1, kati 2, apartamenti 5, Urdhruje Berat.Cmimi ne ankand te trete eshte ne vleren 1,411,200 (nje milion e katerqind e njebedhjetete mije e dyqind) lekë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Njoftim: Ne date 01.12.2017 ne oren 16.00 ne zyrën e permbartuesit gjyqësor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhje, Njesia Tregtare nr.10, Tiranë", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se palaujtshme te llojit llojit "Apartament" me siperfaqe 52.01 m², me volum 1, faqe 175, numer pasurie 1/214+2-15, ne zonen kadastrale 1664, me adrese Lagjia "Puntori", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushe Kruje.Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 1,361,671.36 (nje milion e treqind e gjashtedhjetete e nje mije e gjashteqind e shtatedhjetete e njerike tridhjetete e gjashte) lekë.

Aleksandër Arvizu:

Akuzat për Tahirin, serioze. Ilir Meta ishte zgjedhja e duhur për president

Alfred Lela

Kjo është intervista e parë e Aleksandër Arvizu për një media shqiptare, pas largimit nga Departamenti i Shtetit. Në të shfaqen hendeqet e një interviste 'via email' (te mungesa e pyetjeve pasuese), por gjithësi është një bisedë, që është munduar të kapet te damarët e çështjeve që shqetësojnë, sot, dhe apo nesër Shqipërinë politike, të paktën.

Z. ambasador, ta fillojmë nga fundi, edhe pse Anne, bashkëshortja juaj, lajmëroi largimin tuaj nga Departamenti i Shtetit, disa gjëra mbetën të paqarta, a u larguat, dolët në pension, apo u ngopët?

Sistemi i Burimeve Njerëzore (HR) në Shërbimin e Jashtëm amerikan është shumë i ndërlikuar, është ndryshe nga pjesët e tjera të qeverisë amerikane. Unë kam qenë në pozicionin tim të mëparshëm si DAS (Deputy Assistant Secretary) për më shumë se dy vjet dhe ishte koha që të ndërroja pozicionin. Dështimi për të shqyrtuar për tri pozicione të ndryshme: një në Uashington, dhe dy të tjera jashtë Amerikës. Por nuk u mor asnjë vendim. Kështu që m'u desh të largohesha. Nuk është mirë kur vendimet merren duke mos u marrë vendime. Por, nuk ka gjë.

A mbështesni atë që Anne tha në një status në "Facebook", ku ajo ishte shumë e ashpër rreth mënyrës se si po shkojnë gjërat në Departamentin e Shtetit që pas mbërritjes së z. Tillerson?

Cdokush që është i mirinformuar do të thotë se diplomacia amerikane po degradon në këto administratë. Dhe ky degradim është veçanërisht i dukshëm në Departamentin e Shtetit. Shumë diplomatëve seniorë (të karrierës) u kërkua të largoheshin apo ikën vetë, sepse nuk mbante më. Këta janë diplomatë amerikanë me përvojë dhe të shumë trajnuar, që kanë shërbyer si në administratat demokratike, ashtu edhe republikane përgjatë viteve. Nuk është një pamje e bukur.

Kur Politico.al ju kontaktoi në shtator, ju thatë se "nuk ju ishte kërkuar të qëndronit". Kështu që u larguat. Në të njëjtën kohë pati zëra se po merreshit në konsideratë si zgjedhje e mundshme për vendin e ambasadorit amerikan në Kosovë. A është kështu?

Do të kishte qenë një ndër të përfaqësuesha Shtetet e Bashkuara në Kosovë.

Cili është statusi juaj aktual: a jeni një diplomat në pension, që po shihni mundësinë që përvojën e gjerë në diplomaci ta përdorni në sektorin privat, siç kanë bërë shumë diplomatë para jush dhe vazhdojnë të bëjnë?

Nuk jam i sigurt se çfarë do të bëjë në të ardhmen. Kam nevojë për

disa muaj pushim dhe për t'u munduar. Jam 59 vjeç, kështu që kam edhe disa vite të tjera të mira (qesh). Patmirësisht situata jonë financiare është e mirë dhe jam mirënjohës për këtë.

A i ndiqni rregullisht zhvillimet në Shqipëri?

Po, mundohem të informohem me sa më lejon koha, kryesisht duke hapur portale të ndryshme 'online' herë pas here, megjithëse siç t'i di, unë nuk lexoj apo as di shqip, gjë që mbetet një problem. Jam në kontakt me miq atje dhe ata më 'ndihmojnë' të kuptoj se çfarë po ndodh (qesh).

Cilët janë disa prej njerëzve me të cilët mbani kontakte në Tiranë? (Qesh)

Ndoshta nuk do t'u bëja

Ndoshta cinizmi dhe hipokrizia. Sigurisht të politikës, por jo vetëm në politikë. Ngado.

Mendoj se mund të flisni më lirshëm tani që nuk jeni më i kufizuar nga kushtëzimet e Shërbimit të Jashtëm. A do të thotë kjo se mund të jeni më kritik ndaj qeverisë "Rama"?

A po thonë se nuk kam qenë kritik gjatë kohës që isha në detyrën time zyrtare? Jam i sigurt se z. Rama nuk do të ishte dakord.

Z. Rama arriti të merrte një mandat të dytë, por Zotat nuk e donin të lumtur. Shpërthimi i skandalit ku përfshihet ish-ministri i tij i Brendshëm, z. Tahiri, e tronditi qeverinë e tij, e cila tani po përpiqet të mbledhë copat.



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri

Qeverisja e vendit është kthyer në 'menaxhim të krizës'. Çfarë mendoni për z. Tahiri gjatë kohës që ishit ambasador?

Menaxhim krize? Nuk jam i sigurt se bie dakord me këtë vlerësim. Sa i takon z. Tahiri, ambasada amerikane kishte një raport shumë të afërt dhe bashkëpunues me të kur ai ishte ministër i Brendshëm. Dhe jo vetëm me të, por edhe me zyrtarë të tjerë të lartë të asaj ministrie, përfshirë Elona Gjebrën dhe Genc Gjocajn. Dhe, sigurisht, të gjithë strukturën e Policisë së Shtetit. Bashkëpunimi ishte i shkallës së parë.

- Çfarë mendoni për të tani?

I kam lexuar disa prej akuzave kundër tij dhe ato janë serioze. Dhe nuk e di se çfarë është e vërtetë dhe çfarë jo. Nëse ka bërë diçka të gabuar, dhe kjo mund të provohet në gjykatë, atëherë ai patjetër që duhet të përballtet me pasojat. Por, siç e thashë, nuk e di nëse ai është fajtor.

Partia Socialiste në pushtet refuzoi t'ia hiqte imunitetin par-

lamentar z. Tahiri. Pati nga ata që e panë këtë si një fillim shumë të keq të procesit të vetingut, pasi jepet ideja sikur 'makina e vetingut' do të kapë vetëm politikanë të anës tjetër, apo gjykatës dhe prokurorë, që nuk janë në 'zonën e miqësisë'...

Deputetët gëzojnë imunitet sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Shqipërisë, për arsye të ndryshme. Por imuniteti nuk duhet të jetë mburojë nga hetimet, nëse ka prova të besueshme për aktivitet kriminel.

Në një tjetër lëvizje të çuditshme, z. Rama zgjodhi si kryetar të Parlamentit z. Gramoz Ruci (në fakt, ai pëlqen t'i drejtoheshe me shoku Gramoz). Si ju duket kjo zgjedhje?

Pse është e çuditshme? E kam takuar Rucin disa herë kur isha ambasador. Bisedat tona ishin gjithnjë produktive dhe të sjellshme. Socialistët kanë shumicën, kështu që është e natyrshme që një ligjvënës veteran i socialistëve të bëjë kryetar Kuvendin.

Ambasadori Lu refuzoi të merrte pjesë në seancën e parë plenare të Kuvendit të ri, hera e parë për ceremoni të tilla. Disa e panë këtë si mënyrën e tij për të shprehur mosdakordësinë me zgjedhjen e Ramës për kreun e Kuvendit. A është e drejtë të thuhet se ambasadorët amerikanë nuk veprojnë si persona privatë, por si përfaqësues të Uashingtonit, duke e bërë rrjedhimisht pozicionin zyrtar të Shteteve të Bashkuara të shkojë përkundër zgjedhjeve të tilla: komunistë të linjës së ashpër të përfaqësuar në pozicione të tilla pushteti?

Ambasadorët amerikanë në Shqipëri kanë shumë fleksibilitet për të bartur detyrat e tyre, por gjithnjë si përfaqësues zyrtarë dhe jo si persona privatë. Kam dëgjuar se ambasadori Lu nuk ishte i pranishëm në seancën e parë plenare. Jam i sigurt se ka pasur arsytet e veta, ndoshta ka pasur një angazhim tjetër. Duhet të pyesni atë.

Ndërkohë z. Meta është bërë president. A jeni në pozita miqësore me të? A ishte ai zgjedhja e duhur për këtë post? A bëri ai një zgjedhje të mirë duke e pranuar këtë post?

Kam shumë respekt për z. Meta. Po, në jemi në kontakt, megjithëse ai është gjithnjë një person i zënë me punë si kryetar shteti dhe unë e kam parasysh këtë. Për shkak të statuturës së tij politike, z. Meta nuk është peng i asnjërës prej partive politike kryesore dhe kjo është një gjë e mirë. Po, mendoj se ai është një zgjedhje e mirë si president. A ishte një zgjedhje e mirë për të? Duhet të pyesni atë. Më lejoni të shtoj diçka për z. Meta: Si çdo lider tjetër politik në Shqipëri, ai ka të mirat dhe të metat e tij. Por ka pasur një prirje për ta 'demonizuar' z. Meta dhe LSI, dhe për t'i fajësuar ata shpërpjestimisht për problemet e politikës shqiptare. Kjo është gjithashtu e



Presidenti Ilir Meta dhe ish-ambasadori i SHBA-ve në Shqipëri, Aleksandër Arvizu

vërtetë edhe për të ashtuqajturin faktor ndërkombëtar, përfshirë edhe Uashingtonin zyrtar. Ishte frustruese të dëgjoje nga Departamenti i Shtetit gjëra të tilla si: "Pse të merremi me Metën dhe LSI? Sigurohuni që Berisha (më vonë Basha) dhe Rama të pajtohen për këtë apo atë gjë". Dhe unë u thosha: "Nuk e kuptoni, apo jo? Berisha dhe Rama (apo Basha dhe Rama) nuk do të bien dakord dhe ky është problemi!". LSI është pjesë e dinamikës. Është realiteti politik i Shqipërisë sot. Çdo zgjidhje që nuk e përfshin konstruktivistisht LSI, nuk është serioze.

-Në pranverë, kur ju vizituat Shqipërinë, u bëtë pjesë e negociatave të cilat u pasuan nga një vizitë finale e z. Hoyt Yee dhe një marrëveshje ndërmjet z. Basha dhe z. Rama, e quajtur "Paketa McAllister Plus". Në retrospektivë, çfarë mendoni për atë marrëveshje?

Përkrahimi që i bëni rollit tim është bujar. Ambasadori Lu ishte i sjellshëm që më la të merrja pjesë në ato takime. "Pakti" →



bolike. Në një rrafsh më të gjerë, është e rëndësishme që përpjekjet reformuese ta çojnë PD në erën post-Berisha, në mënyrë që të bëhet kompetitive sërish. Është e rëndësishme për qindra mijëra votues shqiptarë që e konsiderojnë veten "konservatorë", të kenë një zë të besueshëm që i përfaqëson interesat e tyre, të tillë që të mund të sfidojë të majtën në zgjedhje. PD-së i duhet punë.

- Z. Basha pa një prej arsyeve të humbjes kriminalizimit e procesit elektorral dhe parave të drogës të përdorura për të tjetërsuar apo blerë vota. Kishte nga ata që nuk pajtoheshin me këtë, deri kur u bë publik një hetim i policisë dhe prokurorisë italiane. Trafikantë droge u përgjuan duke thënë se Saimiri (mendohet se bëhet fjalë për ish-ministrin) ka bërë 5 milionë euro, por atij i duhen nja 20 milionë për t'i përdorur në zgjedhje. Ata që ishin skeptikë ndaj argumenteve të z. Basha, tani po e pranojnë idenë se para të shumta, të ardhura nga droga u përdorën në fakt në zgjedhje. Problemi i drogës dhe krimit të organizuar është absolutisht serioz dhe qeveria duhet të bëjë punë më të mirë. A janë përdorur para nga aktivitete të jash-tëligjshme në zgjedhje?

Jam i sigurt se po, por nuk është kjo arsyeja e turrës së PD.

Vendimi i "Top Channel" për të ulur në stol drejtorin e lajmeve, Sokol Balla dhe për të marrë hapur një qëndrim kritik ndaj qeverisë së Ramës u bë lajm i madh javën e shkuar. A është ky rast i "Top Channel"-it në ditën e vet më të mirë (media në opozitë me pushtetin); a është luftë mes mediash për territore, apo është një lëvizje e Ramës për të bërë aleatë të rinj dhe për të harruar të vjetrit?

Kam lexuar për disa nga shumë ndryshimet në "TCH" qëkur iku Kel Joti, disa kohë më parë, por nuk e di historinë e plotë. Për shembull, ata nuk ishin në anën e lajmeve, por të argëtimit, por u trishtova kur dëgjoja se artistë të talentuar si Adi Krasta dhe Eneida Tarifa kishin ikur nga "TCH". Ndoshta kanë ikur për arsye profesionale, nuk e di. Sa i takon departamentit të lajmeve, përveç Sokol Ballës, disa gazetarë profesionistë impresionë kanë shërbyer më parë si drejtorë lajmsh atje, përfshirë Kel Demin dhe Bledar Zaganjorin. Nuk e njoh drejtorin e ri të lajmeve. Shpresoj që Balla të vazhdojë të drejtë "Top Story"-n. Më pëlqen si "Top Story", ashtu edhe "Opinion".

Ambasadori Lu ka bërë zhurmë duke thënë se në janar për herë të parë do të bien në rrjetë ca "peshq të mëdhenj". Shumë janë skeptikë, sepse në të shkuarën shumë "peshq të mëdhenj" u kanë kaluar anash rrjetave dhe disa pyetën 'pse në janar dhe jo tani?'

Gjë e cila na sjell disi të thirrja juaj e famshme 'Act Now!'! Faleminderit që e rikujtoni 'ACT Now!'... Jam krenar për atë që u përpoqem të bënim. Sa i takon përmasës së 'peshqve' që do të kapen, shpresoj se do të bëhet progres serioz me reformën në drejtësi, përfshirë vetëgjin.

Gjatë shërbimit tuaj në Tiranë, jam i sigurt se keni pasur momente të mira dhe të këqija me krerët e lartë të politikës shqiptare. A ju kujtohet ndonjë?

Kishte plot nga të dyja. Një gjë që shumë shqiptarë në mu dhe kuptojnë janë ecnjakët ndërmjet Ambasadës dhe Departamentit të Shtetit në Uashington. Shumicën e

herëve komunikimi dhe koordinimi është i mirë, por jo gjithmonë. Gjatë katër viteve të mia në Tiranë, ndjeva se vetëm një zyrtar i lartë në DSH kishte një pamje të qartë dhe objektive të situatës në Shqipëri dhe ky ishte Tom Countryman. Ai nuk ishte gjithmonë dakord me mua, por unë gjithnjë kisha shumë respekt për të.

Në disa qarqe shqiptare ju konsideroheni 'sorosian'. A jeni i tillë? Pse flitet kaq shumë për ndikimin e Sorosit?

(Qesh) e keni seriozisht? Unë, sorosian? Kushdo e mendon apo e thotë këtë është një idiot dhe shpresoj se do ta botosh këtë. Siç e di çdo shqiptar, Instituti Republikan Amerikan, Instituti Demokrat Amerikan, bashkë me Shoqërinë e hapur të Sorosit janë tri prej organizatave më të spikatura amerikane, që janë angazhuar në ndërtimin e institucioneve demokratike, bazuar në modele perëndimore, që nga rënia e komunizmit. Nëse shohim mbrapa përgjatë 25 viteve të shkuara, nëse do më pyesje nëse Soros dhe SHH ishin ndoshta shumë të përfshirë, apo se kishin shumë kontrata për OJF-të, ndërtimin e kapaciteteve etj., përgjigja ime do ishte: Ndoshta. Ndoshta. Të gjitha këto kontrata janë kompletuar dhe jam i sigurt se përgjatë viteve, të gjithë ata që janë përfshirë në procesin

Ndonjëherë, Tirana i ngjan Panairit të Kotësive të njeriut të varfër dhe është në fakt shumë e sikletshme.

Shih skenën artistike, për shembull. Shqipëria ka kaq shumë artistë të talentuar, por problemi i 'antivlerave' është i keq dhe po sheh rritje. Ka vulgaritet në shumicë, sipërfaqshmëri dhe artificialitet kudo. Dhe disa prej liderëve me inuencë të industrisë së argëtimit duhet të kenë turp nga vetja, sepse ata e inkurajojnë këtë 'mani', këtë garë të turpshme ku 'pëlqimet' në "Facebook" apo "YouTube" blihen si karamelle të lira. Për çfarë? Ndërkohë, shumë talentet premtuese dhe artistë të vërtetë shqiptarë vuajnë dhe janë nën trysni të përhershme për të bërë kompromise në mënyrë që të mbijetojnë. Nuk është e drejtë. Kjo është në njëfarë mënyre një përgjigje e gjatë për pyetjen tuaj, por ajo që po përpigjet të them është se prirjet (trendet) negative në kulturën popullore janë në fakt emblematike për sëmundje më të gjera që në shohim aktualisht në Shqipëri. Të gjithë asin për 'krenarinë' shqiptare, por ajo që duhet është më shumë dinjitet shqiptar, bazuar në kulturën e mrekullueshme, traditat dhe vlerat që e bëjnë Shqipërinë speciale. Mentaliteti komunist është kudo në shoqëri dhe jo vetëm në atë që njerëzit e konsiderojnë si 'të majtë'



Aleksander Arvizu

← apo çfarëdo tjetër që ju doni ta quani, shtrori rrugën për zhvillimin e zgjedhjeve. Zgjedhjet nuk ishin perfekte, por ishin të pranueshme. Kështu që 'pakti' ishte një gjë e mirë.

A është e vërtetë se marrëveshja ishte e llojit 'merre ose lëre', dhe nëse z. Basha nuk do ta pranonte, Uashingtoni do t'i njëhte zgjedhjet e përgjithshme edhe pa pjesëmarrjen e opozitës?

A kishte ndonjë zgjedhje Basha? Nëse PD nuk do të merrte pjesë në zgjedhje, ato do të zhvilloheshin gjithsesi dhe hamendësimi im është se rezultati me shumë mundësi do të ishte njohur nga pothuaj të gjithë në komunitetin ndërkombëtar.

Pjesë e marrëveshjes "Rama-Basha" ishte gjithashtu një Task-Force speciale, e cila pas zgjedhjeve hartoi një raport të gjatë, ku thuhet se zgjedhjet e 25 qershorit u njollosën nga shumë shkelje. Z. Rama e refuzoi raportin si të njëanshëm, duke zgjedhur

në thelb prishjen e marrëveshjes politike të majit. Çfarë mendoni për qeverinë me disa parti, e cila përfshinte disa ministra të opozitës dhe a e keni lexuar apo keni dëgjuar për raportin në fjalë?

Kam dëgjuar për raportin, por nuk e kam lexuar dhe kështu që nuk mund të komentoj.

Partia Demokratike i humbi zgjedhjet dhe disa vëzhgues apo palë të prekura ia hodhën fajin listës së z. Basha dhe zgjedhjes së tij për të përjashtuar nga listat 'gardën e vjetër' dhe zgjedhjen në vend të tyre të emrave të rinj...

Partia Demokratike ishte në një pozicion të vështirë për disa arsye dhe një humbje në vitin 2017 ishte e pashmangshme. Strategjia elektorale ishte një problem madhor, por disa prej vendimeve të diskutueshme të PD për listën e kandidatëve e bënë edhe më keq situatën. Për shembull, moskandidimi i Jozefina Topallit ishte i panevojshëm dhe fyeu shumë besnikë të PD në Shkodër, ku ajo është një figurë sim-

përzgjedhës, qoftë Ambasada amerikane, USAID, Departamenti i Shtetit etj., janë përpjekur të ishin sa më objektivë të mundshin. Por Soros, IRA apo IDA janë organizata të mëdha dhe kanë shumë burime, kështu që po, është krejtësisht e mundur, që ata të kenë gëzuar ndonjë avantazh herë pas here. Por, të fajësosh Sorosin për këtë apo atë gjë, nuk ka kuptim. Ky është rasti klasik i fenomenit të gogolit. Në Shqipëri, ashtu si në Amerikë, ka teoricienë konspirativë që shpikin gogolin për të tërhequr vëmendjen.

Nëse do të evidentojë një problem të vetëm shqiptar, cili do të ishte ai? A është politik, shoqëror, kulturor apo çfarë?

Shqetësohem për Shqipërinë. Shqetësohem sepse them, ja ku jemi, më shumë se 25 vjet pas rënies së komunizmit dhe njerëzit po humbin shpresën. Shoh që cini-zimi po rritet gjithandë. E sheh të pasqyruar në qëndrimet e njerëzve, në kulturën popullore.

tradicionale - është kaq veprues edhe në të djathtën. Po, korrupsioni i duhet luftuar. Ndërkushëmëria, kriminaliteti, të gjitha. Por, pas gjithë këtyre viteve ngjan si bla bla bla. Ajo që duhet bërë është kjo: kolektivisht, duhet të gjeni kurajën dhe frymëzimin për të kapërcyer mentalitetin komunist, sepse ai është çka po e pengon Shqipërinë për të përmbyshur potencialin e saj të plotë.

Një pyetje të fundit, më e lehta dhe më e vështira në të njëjtën kohë: Kush ka qenë ambasadori më i mirë amerikan në Tiranë që nga rënia e komunizmit?

(Qesh) Kjo në fakt është shumë e lehtë. Bill Ryerson, pa dyshim. Ndjekur nga Mariza Lino dhe John Withers. Nxitoj të them se mëdoj se Donald Lu po bën në një punë të shkëlqyer. Dhe di se po flas në emër të gjithë atyre që kanë shërbyer në atë pozicion, kur them se ka qenë mundësia e një jete me kujtime, që ne do t'i gëzojmë gjithnjë.

Politico.al

KRITIKA NE "LIBERATION"

Gazeta franceze: Roli i Xhuvanit, nëna e dëshpëruar e historia personale

Teatri Kombëtar merr pjesë për herë të parë në festivalin "Mettre en scène" në Rennes të Francës me shfaqjen "Lukrecia Borxhia". Trupa e Teatrit Kombëtar e përbërë nga aktorët Luiza Xhuvani, Artan Imami, Xhino Musallari, Vasjan Lami, Indrit Çobani, Lulzim Zeqja, Gentii Deçka, Gent Hazizi, Marsel Rupi, u nis nga Tirana për në Rennes, më 7 Nëntor dhe pas 2 ditësh intensive provash ishte gati të jepte shfaqjen në datat 10, 11 dhe 12 nëntor 2017. Interesi i publikut francez sipas njoftimit të Teatrit Kombëtar ishte shumë i lartë për këtë shfaqje dhe duartrokitje dhe ovacione të shumta shoqëruan trupën shqiptare pas përfundimit të çdo shfaqjeje. Gazeta prestigjioze "Libération" i kushton asaj një analizë të plotë dhe të detajuar duke dërguar gazetarët e tyre në Tiranë për të intervistuar ata që bënë të mundur realizimin e këtij projekti teatror.

Frédérique Roussel*

Në maj Teatri Kombëtar, një vend i pasur me histori do të shkatërrohet. Eric Vigner zgjodhi të ngjise në skenë në shqip pjesën e Viktor Hygosë. Ai i ka ofruar rolin kryesor aktorese së njohur Luiza Xhuvanit, djali i së cilës është aktualisht në burg. Gjasthtë shkronja u sollën në skenë nga aktorët: B,O,R,G,I,A. Janë të mëdha dhe të bardha. Në qendër qëndron kolona pa fund e Bankusit dhe këto përbëjnë thelbin e dekorit. Eric Vigner ka realizuar një skenografi fine dhe të stilizuar të veprës së Viktor Hygosë. Ai ka shfrytëzuar thellësinë brutale të skenës, duke patur parasysh përshtatjen e Antoine Vitez, në 1985: një skenë boshe, e pushtuar nga errësira, e skalitur nga zëri dhe lëvizjet e aktorëve. Çdo gjë luhet në trazizimin e brendshëm të personazheve, në veçanti të Lukrecias, nënës incestuale, e cila do të donte të fshinte me dashurinë e saj krimet e klaneve tiranike.

Për herë të parë në datë 12 Maj, "Lukrecia Borxhia", një pjesë mbi pushtetin (repriza në nëntor në Festivalin "Mettre en scene" në Rennes) u soll në skenë në Tiranë. Kjo nuk është hera e parë që e shohim Eric Vigner-n në Tiranë, drejtor i teatrit CCCB- Teatri i Lorient prej 1996 deri më 2015. Në 2007, ai vjen në Shqipëri, me ftesë të drejtorit të Teatrit Kombëtar në Tiranë, Kristaq Skrami me pjesën "Berberi i Sevilyes" të Beaumarchais duke pasur në vëmendje historinë politike dhe kulturore të vendit. Asnjëherë më parë një regjisor francez nuk kishte drejtuar një trupë shqiptare brenda mureve të saj dhe në gjuhën e saj. Dhjetë vjet më vonë, është pikërisht "Lukrecia Borxhia", vepra e përkthyer për këtë rast, e cila shumëfishon ekot e situatës politike të këtij vendi në Ballkan.



Luiza Xhuvani në shfaqjen "Lukrecia Borxhia"

"Lukrecia Borxhia", gjakmarrja sipas ballkanasve, shfaqja shqiptare në Francë

Ndërkohë, Luiza është një figurë publike e njohur në Shqipëri, që ka ndërmarrë një karrierë ndërkombëtare dhe ka spikatur në filmin "Slogani" (2011), një film franko-shqiptar nga Gjergj Xhuvani, i cili fitoi gminin si filmi më i mirë i huaj në Festivalin e Kanës. Që prej tre vjetësh Luiza jeton në Greqi. "I thashë: "Lexoje pjesën", thotë Eric Vigner. Ajo e lexoi në greqisht dhe e pranoi rolin pas dy ditësh". Ky projekt teatror, provat e të cilit zgjatën dy muaj e gjysmë, shënojnë hyrjen e Viktor Hygosë në reper-

torin e Teatrit Kombëtar Shqiptar, por edhe i bien kamanës së një salle historike. Në fakt, ndërtesa me vendndodhje në zemër të qytetit, shumë afër me sheshin Skënderbej, së shpejti do të shkatërrohet.

Që kur është ndërtuar, është menduar të mos rezistojë shumë. Inauguruar nga Musolini më 1940, kjo sallë italiane (megjithëse me kënde të drejta) është përdorur në fillim si kinema para se të përdorej si teatër: "Topaze" nga Marcel Pagnol ishte premiera që preku skenën e saj më 1945.



"Para kësaj, kishte vetëm teatro amator në Shqipëri", shpjegon Hervin Çuli, 46 vjeç, drejtori aktual i teatrit Historia e teatrit profesional të këtij vendi filloi atë vit. Ai thotë se ashtu siç e tregon edhe historia, vitet e arta të teatrit ishin vitet '60 dhe '70, me aktorë të njohur si Kadri Roshi, Sulejman Pirtarka ose Violeta Manushi.

Kjo, ndodhi para se censura dhe kërcënimet për burgim të pengonin zhvillimin e një kreativiteti më të madh. Gjithashtu, u ndaluan të viheshin në skenë vepra të Çehovit, autor i konsideruar atëherë si pesimist dhe dekadent.

"GJENERATA AMBICIOZE"

Ky vend që deri dje ishte totalisht i mbyllur, u hap në vitin 1991. Si bishti i bilokut lindor, ka pasur mundësi të eksperimentojë mjaft gjëra. Por edhe kultura ka marrë disa goditje. Teatri Kombëtar ekuivalent me Komedinë Franceze me një trupë artistike permanente, pa të ndryshonte numri i aktorëve të përhershëm nga 60 veta në periudhën e regjimit komunist, në 28 sot, madje edhe me kontrata afatshkurtra. Në fillim të viteve '90, politika ka dominuar ndjeshëm dhe shumë artistë u bënë pjesë e parlamentit të Shqipërisë, tregon Hervin Çuli, i shkolluar në Rumani në fillim të viteve '90. Ai ka vënë në skenë vepra nga Çehovi dhe Goldoni. "Kemi jetuar njëzet e pesë vjet tranzicion dhe sot mund të themi se gjenerata e re është ambicioze".

Tregues i një kohe inkurajuese, vendi po njehtë bëm teatros dhe të kompanish teatrore. Publiku i Teatrit Kombëtar është shumëfishuar këto katër e pesë vitet e fundit dhe numri i shfaqjeve është trefishuar.

Në 2016-ën, të gjitha biletalet e shfaqjes "Zbutja e kryeneçës" nga Shakespeare-it, "Tri Motrat" nga Çehovi dhe "Tartufi" nga Mollieri janë shitur paraprakisht. Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro, një grua e letrave dhe përkthyes, është mbështetëse e artit.

Që prej një viti, kryeministri Edi Rama, ka shpallur hapjen e një teatri të ri në një uzinë të vjetër të pashfrytëzuar, "Turbinat". E megjithatë, ndërtesa e Teatrit Kombëtar, e destinuar për të qenë provizore, ka mbijetuar shtatëdhjetë vjet. Gjendja e saj ka degraduar në mënyrë të konsiderueshme, ka krisje, rrjedhje, shkallë që rrezojnë të bien, mungesë ngrohjeje dhe ajri të kondicionuar. Edhe materialet brenda, lënë për të dëshiruar. Është dashur të sillen prozhektorë nga Franca për të ndriçuar ashtu si duhet "Lukrecia Borxhia".

Në lozha, pas shfaqjes, Luiza Xhuvani, që nuk kishte shkëlur në këtë skenë që prej katër vitesh, rrëfeu për rolin: "Më mundësoi të them gjëra që nuk do t'i kisha thënë dot kurrë".

Dhe shton: "Teatri është një kartarsis, Eric Vigner është një regjisor që bën teatër si të ishte film. Ai është kineast", përfundon Luiza Xhuvani, e cila pritet të sjellë në Greqi, rolin e Medeas.

(*I dërguar special në Tiranë (Albania) - 26 Tetor 2017)

PREMIERA

Fatmira Nikolli

"Nuk është plotësisht autobiografia ime, por aty e kam nisur. Më kujtohen trazirat e 1997-ës, krismat, momentet që nuk kishte për të ngrënë, sepse çdo gjë ishte e ngrysur dhe asgjë nuk funksiononte. Më pas ikja ime nga Shqipëria edhe telefonatat nga prindërit".

Balerini shqiptar Eno Peçi, është rikthyer në Tiranë me një shfaqje premierë. Vite më pas nga ikja kujton se çfarë la pas atë kohë. Me gjasë, ato që la pas, qenë ato që e shtynë të ikte, pa e kthyer kokën. Dikur, ai pasi kishte mbaruar shkollën e baletit, nuk arriti dot të hynte në teatër. "Nuk i kisha mundësitë. Do kisha shumë dëshirë që atëherë nëse do të mbaroja shkollën e Baletit edhe futesha në TKOB. Por mundësia nuk ishte për shkak të trazirave". Për këtë arsye, ky rikthim do të thotë shumë për të. Solisti i parë i Operës së Vjenës, vjen për herë të parë në Shqipëri me një krijim të tijin si koreograf.

"Exil-Deja Vu", që vihet në datat 25 dhe 26 nëntor në skenën e Akademisë së Arteve është një shfaqje që pritet të thyejë limitet e imagjinatës me një lojë fizike, që gërsheton lëvizjet koreografike, me interpretimin e fortë artistik. Koreografi Eno Peçi nuk mund të qëndronte larg skenës shqiptare, ndaj do të jetë në krye të trupës së balerinëve të TKOB dhe si protagonist, balerin.

Premiera "Exil-Deja Vu" nga Eno Peçi, ndërthur dëshirën për të ikur dhe kujtesën e mbamendjen se çastin, që po jeton, e ke jetuar edhe më herët.

"Si bazë kam marrë kohën e viteve 1987-1988. Si bazë kanë qenë ato trazirat dhe ajo më frymëzoi, sepse edhe vetë i kam kaluar këtu, si të tjerë kolegë të tjerë të mitë apo familje të tjera. Thashë dua të bëj diçka me këto gjëra, sepse ato momente i kam kaluar edhe vetë", ka rrefyer ai.

SHFAQJA

Kur sqaron narracionin e pjesës së parë të shfaqjes, "Exil", thotë se nuk ishte i vetmi që iku. "Ka pasur edhe shumë moshatarë të mi. E kam marrë këtë si temë, sepse fëmijët dërgohen në Exil që të kenë një jetë më të mirë. Kam marrë dy familje të ndryshme që kanë problemet e tyre që i detyrojnë të çojnë fëmijët e tyre në EXIL", thotë koreografi.

"EXILI", ngrihet mbi varfërinë, skamjen, vuajtjen dhe pasigurinë. Dy familje ku babai dhe nëna vuajnë për të ardhmen e pasigurt të fëmijës së tyre dhe detyrohen t'i dërgojnë jashtë vendit për një të ardhme më të mirë. Përveç perceptive, që duhet të kalojnë për këtë vendim të vështirë, nëna dhe babai përballen me paragjykimet e pjesës tjetër të familjes, komunitetit ku jetojnë dhe shoqërisë. A do të ketë shpëtim? A do të mundet "të dalë dielli" dhe jeta e tyre të jetë e paqte dhe vuajtjet të marrin fund, është tranzicioni i familjes, i cili për disa është më i rreptë dhe për të tjerë më i butë. Ditët e bardha duken të largëta, është një

Eno Peçi:

Ika mes krismave nga Shqipëria, nuk kishte për të ngrënë...

Premiera e baletit në datat 25-26, "Exil-Deja Vu", një shfaqje për ata që ikën

Ylli i skenës vjeneze në Tiranë: Ka nota biografike, por baleti shkon përtej



Balerini Eno Peçi gjatë provave

shishe alkool, që u mpin kokën, si shpëtimtari i vetëm i momentit, por... gjithçka e zezë rikthehet përsëri, kur afshet e dala prej trupit rikthejnë në realitet njeriun e vuajtjes.

Ndërsa "Deja Vu" ndërthoht mbi ndjesinë se po ripërfjetojmë një çast që e kemi jetuar edhe më herët.

Peçi, thotë se ndjen kënaqësi duke punuar me balerinët sh-

qiptarë. "Ka qenë një punë e dyanshme, si koreograf e balerin. Mendoj se po shkojmë në drejtimin e duhur. Pjesën e parë e kam zgjedhur, sepse është një vepër që më ka frymëzuar edhe kur kam qenë fëmijë, kanë kaluar 20 vite, por sërish mendimet janë atje. Ndërsa pjesa e dytë është si



mumin e balerinëve edhe këtë nuk e mendoj vetëm unë. Të krijosh diçka nuk mund ta bësh vetëm, por janë edhe balerinët, që krijojnë edhe kanë një koncept për të bërë diçka të bukur".

Shton po ashtu se balerini vetëm kur shkon në skenë çlirohet pas duartrokitjeve. "Krijimi është gjithë kohës me ty, sepse kërkon që t'i japësh një zhvillim artistik, që të nxit shumë. Koreografi, nuk është të bësh vetëm lëvizje, janë shumë elemente, që në fund përmblidhen bashkë edhe bëjnë magjinë e vet. Megjithatë frika është gjithmonë aty, sepse publiku nuk është i njëjtë edhe njerëzit i shohin gjithnjë gjërat ndryshe. Duhet të kesh besim te vetja, që të marrësh risikun edhe ta bësh atë që ke në kokë".

I pyetur për jetën e tij familjare ai tha se bashkëshortja e ka lënë baletin, sepse nuk ka më të njëjtën ambicie. "Është shumë e kënaqur dhe shijon kohën e saj me fëmijët. Është balanca që kemi të dy, ajo kujdeset për familjen, unë për punën, pavarësisht se jam gjithmonë aty për fëmijët. Është një balancë që funksionon".

KONCERTI VJENEZ

Eno Peçi prej 15 vitesh punon në Operën e Vjenës. Ai është zgjedhur të interpretojë edhe në koncertin e shumëpritur në të gjithë botën me rastin e Vitit të Ri.

"Është diçka e lehtë, një traditë vjeneze, por që unë nuk mund të përfaqësohem ashtu, pavarësisht se jam në Vjenë edhe kërcëz valset e Vjenës, është një traditë që ndodh çdo vit. Arti nuk ka kufi. Procesi që regjistrojmë këtë mbrëmje është i veçantë, janë detaje, që i njohim. Është një kënaqësi që e kam dashur përherë. Vjena është një nga pikëqendrat më të mëdha kulturore në art dhe është arritje e madhe për çdo shqiptar që vjen aty", tha ai.

80TE RINJ CERTIFIKOHEN SIMJESHTER TE MONUMENTEVE TE TRASHEGIMISE

80 mjeshtërvë dhe ndihmës mjeshtërvë të rinj është kaq i rëndësishëm".

Duke vlerësuar këtë nismë tepër kurajdhënëse Kumboar theksoi impaktin që kanë politika të tilla dhe bashkëpunimi me partnerët vendas e të huaj jo vetëm për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, por duke e parë atë si një mënyrë të fuqishme të zhvillimit ekonomik.

Për herë të parë në tri dekada, specialistët e vjetër të restaurimeve patën mundësinë të trajnojnë në teori dhe praktikë generatën e re të mjeshtërvë. Gjirokastra, Berati dhe Korça kanë tashmë 80 mjeshtërvë dhe ndihmës mjeshtërvë të certifikuar, për punimet e gurit, drurit, metaltit dhe suvasë në ndërtesa historike, falë projektit "Aftësi për Punësimin e së Nesërmes", projekti, i cili nisi në muajin dhjetor 2016, në mjediset e Ministrisë së Kulturës, ku u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për projektin "Aftësi për Punësimin e së Nesërmes", financuar nga GIZ dhe SIDA. Projektin "Aftësi për Punësimin e së

Nesërmes", ka për qëllim ruajtjen e teknikave tradicionale, kualifikimin e personave që operojnë në këtë fushë, rritjen e cilësisë së punimeve (sipas standardeve të restaurimit dhe konservimit) si dhe më shumë mundësi punësimi për të rinjtë dhe emigrantët që vendosin të kthehen për të punuar dhe jetuar në Shqipëri. Ky projekt tregon se trashëgimia kulturore kombinon të drejtën për kulturë dhe të drejtën për zhvillim, përcimin e dijeve nga mjeshtërvë e vjetër tek ata të rinj që punojnë në këto site të trashëgimisë. "Aftësi për Punësimin e së Nesërmes" u mundësua nga CHwB Albania, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ririsë, Ministria e Kulturës, Ministria e Ekonomisë të Shtetit Federal të Hessen-it nëpërmjet GIZ, bashkëpunimi gjermano-shqiptar dhe qeveria suedeze, drejtorja rajonale e formimit profesional publik, drejtoria rajonale kombëtare kulturore, Gjirokastër, Korçë, Berat, Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Opinion i Ditës

Litari grek, si i Nastradinit jashtë varrit

Nga Hasan Luçi

(vijon nga faja 1)

... mbaruan me premtime për t'i vazhduar edhe në Tiranë, inshalla jo në kalendat greke, por si duken bathët janë ende disi larg pashkët, se "Kali i Trojës" veprori me dinakëri për të mos dhënë asnjë fjalë të fundit, pra vijon hiq e mos këput, duke kërkuar gjoja me mirësjellje...



zgerojnë territoret e pakicës greke, siç po bëjnë me Himarën, ku nga 7 fshatra vetëm në tre flitet greqisht, po ku gratë flasin e qajnë në shqip në atdheun e tyre, se greqishtja s'është gjuhë e nënës, por e tregtisë me fqinj.

Shqiptarët kanë dhanë ndihmën më të çmuar për çlirimin e popujve të tjerë dhe sidomos për fqinjin Greqi, se kishin kaluar të mira e të këqija së bashku nga pushtuesit e huaj në shekuj. Por këta u tradhtuan në mënyrën më të poshtër, se me forcimin e shtetit grek në shek. XIX filluan gjoja...

Pse po hesht ambasada jonë në Athinë, deputetët e deri kryeqeveritarë që i kanë parë këto parulla shovene!? Vetë kam shkruar edhe më parë, por nuk kam parë ndonjë reagim për t'i gjuajtur me top oreakset greke parlamentare.

qin" dorë nga origjina arbërore shumë shekullore dhe mësuang juhën greke, por në shtëpi ruajnë gjuhën e traditat atdhetare, ndërsa Greqia i harroi heronjtë arvanitas çlirimtarë të saj.

Qysh në vitet '50 të shek. XIX bandat greke të Grivas filluan sulmet e masakrat në trojet shqiptare fqinj, duke kulmuar me luftën e Lëkurësit në 1878, ku shqiptarët u dhanë një mësim të mirë për turpin e Greqisë. Perandoria osmane dhe Patriarkana, në marrëveshje kriminale, filluan t'i dhuroman Greqisë troje shqiptare.

qin" dorë nga origjina arbërore shumë shekullore dhe mësuang juhën greke, por në shtëpi ruajnë gjuhën e traditat atdhetare, ndërsa Greqia i harroi heronjtë arvanitas çlirimtarë të saj. Kjo trysni shovene e mostolerancë grekomadhe nuk ndodhi në Itali me arbëreshët ortodoksë e katolikë. Greqia ua ndaloi gjuhën shqipe arvanitasve dhe çamëve për të mos guxuar të njiheshin si pakicë etnike, gjë që ua mohuan gjithë pakicave në Greqi.

Greqia spekulon me historinë e vet e jo më me historinë e marrëdhënieve me fqinjët, sidomos me historinë shqiptare që nga Homeri. Enea etj. sidomos nga Tuqidi di etj. që nisi veprimtarinë shovene për mohimin e përvetësimin e historisë së shqiptarëve...

Sot Greqia, nga zori dhe pak me dashje, bën sikur do të zbusë konfliktet e ngërçin mes dy vendeve, por sërisht zyrtarët nuk heqin dorë nga provokimet e sulmet diplomatike nga mediat private, zyrtare dhe deri të kryeministrit e presidentit grekë.

Ky qëndrim permanent grek u ndihmu nga aleatët esatpashistë, si Sali Berisha e Luzlim Basha etj., që bënë një traktat miqësie kallb; marrëveshjet e detit e të varrezave greke e tjera hinere, që do zbulohen, të cilat u dhanë dorë grekëve të këmbëngulim ende në fitore, duke shpresuar në përçarjen e shqiptarëve dhe në mangësitë e politikës shqiptare...

Edhe BE nuk po bën atë që ka për detyrë institucionale për t'i ndaluar sulmet e anëtarit të tij Greqi, e cila nuk zbaton rregullat themelore të BE, pa le më fqinjësinë e mirë, dhe pranon kërkesat greke deri veton për t'i bërë presion jo vetëm Shqipërisë, por edhe vetë BE-së, duke e kërcënuar me aleatin

Opinioni i Ditës

Krimi dhe politika, çfarë duhet të komunikojë PS dhe PD

Nga Julian Zyla

(vijon nga faqja 1)

... mendojnë për krimin dhe drogat." Kush nuk e kishte një ide për Shqipërinë, pas kësaj fjalie, e krijoj. Diçka nuk ka shkuar si duhet në këtë fillim artikulli. Ose shkruesi/t e fjalimeve kanë pasur këtë ide dhe Kryeministri Rama nuk ka mundur ta zëvendësojë me një fillim pozitiv, ose Kryeministri është autori dhe stafi nuk ka insistuar mjaftueshëm deri në ndryshimin e tij.

Natyrisht, në artikull, më pas cilësohet se ky imazh është i padrejtë ndaj vendit tonë, kryesisht ligjzbatues. Por, edhe në këtë fjalë theksi çuditërisht është zgjedhur të vihet te fakti që për të hequr këtë imazh do të duhet kohë (dhe vepërim). Sa duhet të komunikojë qeveria në çështjen e krimit? Çfarë duhet të komunikojë? A i shërben ideja e shpërndarjes së përgjegjësisë? A duhet t'i përgjigjet akuzave? Çdo akt komunikimi nga ana e qeverisë, brenda çështjes së krimit dhe politikës, ofron material për vazhdimin e çështjes. Atëherë cila do të ishte një strategji për këtë çështje për PS? Po Partia Demokratike si mund ta menaxhojë në maksimum këtë situatë?

Lëvizja e fundit e Partisë Socialiste ishte eksporti i përgjegjësisë nga dimensionin kohor, pra, qeveria e mëparshme, në dimensionin hapësiror, pra, vendet e Bashkimit Europian. Gjithashtu, qeveria po përpigëte të theksojë aksionet e suksesshme të policisë. Këta dy elementë, në letrat drejtuar udhëheqësve europianë dhe në sh-



krimin nga Kryeministri në "Financial Times", u shfaqën të ndërthurur. A është kjo strategjia fituese: Ne nuk jemi të vetmit fajtorë dhe po arrijmë rezultate?

Debatet dhe zhvillimet e fundit edhe pse mund të mos kenë provuar lidhjet e krimit me politikën, minimalisht, kanë konfirmuar tashmë çështjen e krimit. Por, njerëzit e kanë të vështirë të mendojnë përgjegjësit të tjerë për situatën përveçse një kryeministër në mandatin e dytë. Gjithashtu, sukcesi i policisë, në rastin më të mirë për qeverinë, mund të shihet si korrigjim i situatës së krijuar po vetë. Pra, ato që njerëzit mendojnë nuk mund të ndryshohen nga kjo strategji komunikimi. Çfarë i mbe- tët qeverisë për të thënë?

Në këto kushte, qeveria duhet të qëndrojë sa më pak në këtë terren. Kjo temë nuk i bën mirë brenda apo jashtë kufijve. A do të thotë kjo që nuk mund të reagojë ndaj akuzave? Reagimi duhet të jetë një përgjigje-objektiv. Pra, e vetmja gjë që qeveria mund të thotë pa u

vetëdëmtuar është: Lufta ndaj krimit është për ne një nga objektivat kryesorë. Çdo tentativë tjetër komunikimi do të ishte ftesë për të qëndruar më gjatë në këtë temë, ku sa më shumë të lëvizë aq më shumë do të mbytet. Përgjegjësinë nuk mund ta ndajë. Policia po korrigjon. Gjithçka që mund të ofrojë është angazhimi maksimal.

A po e shfrytëzon si duhet Partia Demokratike këtë temë? Deritani deklaratat e opozitës për këtë çështje janë pajisur me rëndësinë e vetë kryetarit të partisë Lulzim Basha. Ai denoncon krimin në vend. Ai denoncon lidhjet e krimit me politikën, sipas tij. Ai kërkon largimin e Edi Ramës. A duhet të thotë Basha dhe PD më shumë apo më pak? Ja dy konstatime dhe një teori që do të mund ta luani.

Z. Basha është shprehur se krimi është tashmë në fazën e pastrimit të parave. Ai, gjithashtu, thotë se qeveria po kërkon të manipulojë publikun. A mjafton të thuhet gjërat? Në një emision televiziv, ish-ministri Manjani tha se "Disa

njerëz kanë dhoma të mbushura me para". Këto para duhet të gjejnë një mënyrë për t'u përdorur tashmë, tha ai. Mjafton të krahasojmë këtë imazh me deklaratat konstatuese të z. Basha për të kuptuar që, shpesh, gjërat duhen qartësuar, jo thjesht thënë. Gjithashtu, duhet lënë me aq: Largimi i Edi Ramës duhet të jetë pasojë, jo synim.

Së dyti, deklaratat e kryera nga kryetari i opozitës Basha i japin peshë denoncimeve në sytë e publikut. Por, ndërkohë që kjo shkon në të mirën e secilit denoncon, shkon kundër imazhit të z. Basha, i cili konsumon figurën e tij në terren negativ PD-së i duhet të impajtojë figura të reja për deklaratat e saj. Besueshmëria e akademikëve mund të ishte një zgjidhje.

Së fundmi, teoria që PD do të mund të luante, sa i përket krimit, duke përmblodhur idetë e saj: Kjo qeveri nuk do të hedhë poshtë bandën, sepse do të dobësojë si financiarisht dhe politikisht. Çmimi i mirënjohjes nga opinioni publik nuk do të mjaftonte për të balancuar humbjen. Kështu, e vetmja qeveri që do të zgjidhte çështjen e krimit do të jetë qeveria e ardhshme. PS duhet të kishte vendosur që në fillim të hynte në pushtet pa krimin. Tashmë nuk mund të ekzistojnë dot politikisht pa të. Vetëm një qeveri e pastër që në fillim do të mund të zgjidhte këtë çështje.

Në artikullin për "Financial Times" Kryeministri Rama shkruan: "Prej vitesh të quajtur kryeqyteti i kanabisit të Europës, Shqipërisë i erdhi në majë të hundës dhe reagoi". Shpresojmë që në një mënyrë apo një tjetër të kemi parim të vërtetë për këtë çështje.

← ortodoks rus për lëshime gjeostratejike në Mesdhe, për t'u mbrojtur edhe nga Turqia nëse nuk përbushen orekset grekomëdha. BE nuk reflekton aspak me drejtësi dhe t'i hapë arkivat për të parë krimet e copëtimit të trojeve shqiptare etj. nga paraardhësit e tyre, dhe sipas politikës së sotme integruese, të jap drejtësinë e munguar për të drejtat dhe liritë e shqiptarëve në trojet e veta dhe të shqiptarëve në Greqi. BE, siç pohoi z.Hahn, "Duhet të punojmë së bashku për të korrigjuar së bashku", por këto fjalë janë si era me shiun, për brenda e jashtë vendit tonë, pa masa reale e të qëndrueshme, pasi duhet biseduar hapur, duke vënë gishtin në plagët e kaluara dhe jo me diplomaci dhelparake. Këto lëshime e trimërojnë Greqinë, pasi grekët, si të majtë dhe të djathtë, apo edhe "Agimi i Artë" dëshiat etj. janë të gjithë në një mendje për synimet ndaj trojeve shqiptare. Grekët janë trimëruar gjithmonë së gëshëntjat

nga zjarri i kanë nxjerr me forcën e aleatëve në çdo kohë. Edhe me mërgatën ekonomike të re shqiptare në Greqi, qeveritë greke bëjnë të fortin dhe qeveritë shqiptare më tepër heshtin apo kuisin disi rrallë për të mos pësuar hatatë nga Greqia fuqimadhe, e cila ka kërcënuar Shqipërinë, edhe me forcën ushtarake para pak kohësh, duke mburrur forcën e vet, megjithëse është anëtare e NATO-s.

Greqia duhet t'i thërrasë mirë mendjes, se Ballkani, i bërë fuçi baruti nga fëmijët shovenë e fuqitë e mëdha, nuk ka gjasë të ribëhet sërisht, pasi kohët kanë ndryshuar dhe faktori shqiptar, Shqipëria e Kosova dhe shqiptarët ende të kolonizuar, tashmë dalin forcë e qëndrueshmërisë së gjendjes në Ballkan. Po edhe arvanitët e camët nuk janë më në letargjinë e dhunës grekomadhe, se po ndërgjegjësohen për liritë dhe të drejtat e tyre. Lëvizja e vetëvendosjes së popujve po rindizet, se mjaft kanë vuajtur

e vuajnë nga padronët skllavopronarë, feudalë e kapitalistë. Greqia po vuan nga krizat e forta ekonomike e të ndërgjegjes me bëmat e saj dhe miqtë nuk do t'i japin dorë sa herë u teket dhe u rrezikohet pushteti afendikojve grekë shovenë, që provokojnë rëndë edhe miqtë e aleatët e vet të vjetër e të rinj. Si të duan le të veprojnë, por kokën do ta hanë një ditë nga vetë populli grek.

Ne si shqiptarë duhet të jemi më tepër vigjilentë në këto koniunktura euroatlantike e globale, të mbarsura me sfida të rrezikshme për të gjithë botën, se plan e subversive po ziejnë në kazonë e mirënjohura tashmë nga opinioni publik. Në veçanti duhet të jemi vigjilentë në rrjedhat e sotme integruese me grekët, serbët, malazezët e maqedonasit, që nuk kanë nxjerrë ende mësimë nga dëshimet brenda e jashtë vendit të tyre.

I uroj qeverisë "Edi Rama" të bëjë detrytar atdhetare të shtëpisë

me kujdes e maturi, se "Kali i Trojës" nuk heq dorë kursesi nga huqet e xanaxat shekullore. Duhet ruajtur shumë nga kompromiset e klimës integruese në BE, gjoja për hir të edukimit të brezave të rinj me historinë e re, duke cenuar historinë reale, siç ka ndodhur, duke i hequr sharjet, fyerjet etj. që fëmijët i kanë më të thekura se në kundëri me shqiptarëve. Kështu më tepër duhet të ndryshojë mendësia e fëmijëve se sa e jona gjithmonë tolerante, e matur, pa agresivitet. Greqia nuk duhet të tundë më flamurit e fitores e drejtësisë shovene dhe aleatët e saj të ngushtë duhet të marrin guxim t'i heqin veshin pak, se po i turpëron ende. Çështja çame nuk duhet mbyllur në asnjë mënyrë, si më kryesorja. Asnjë pëllëmbë tokë, det e piramidë nuk duhet të bëhet kurrë punë pazari as me grekët, as me serbët, as me malazezët, as me maqedonasit. Është koha të mbrojmë më së miri veten dhe brezat e ardhshëm!

HOROSKOPI

DASHI
Me pozicionimin e Hënës në lidhje me Neptunin, t'i hyni punës në zyrë nuk do të jetë e lehtë. Do të donit të ishin plotësisht në një vend tjetër dhe kjo bie në sy. Më mirë të mos shpërndroheni nga gjëra të ndryshme dhe të përpigëni të jeni praktik.

DEMI
Do të jetë një ditë më e qetë se e mëparshme, por jo e mëlqitshme. Jepini për të guar përrapa atë që keni nisur me entuziazëm. Kudo përreth jush do të gjeni një terren pjellor për të zbatuar projektet tuaja më ambicioze.

BINJAKET
Do t'i ndani idetë e juaja me të tjerët dhe to të merrni miratime nga ata që i vlerësoni. Dhe mos u shqetësoni, askush nuk do të qajet, nëse lini mënjëri ndonjë hollësi me pak rëndësi. Miqësi për t'i forcur apo për t'i rribzuar. Ndoshta pas një kontakti fillestar virtual, një takim real!

GAFORJA
Një çështje me disa paqartësi ju vërë pak në vështirësi, dhe për t'u çiluar nga dyshimet duhet të përdorni të gjithë vullnetit tuaj. Parapërgëni persona të pranë dhe të drejtëpërdrejtë, edhe pse për fat të keq jo të gjithë janë kështu.

LUANI
Të besoni më shumë të vetja, do t'ju ndihmojë të arriri rezultate edhe më domethënëse, qoftë në lidhje me punët e juaja, qoftë në lidhje me njerëzit. E dini mirë se njerëzit nuk gjokhen nga paraqitja, por me një prezantim të mirë do të jeni vërtet në formën e juaj më të mirë!

VIRGJERESHA
Mos lejoji që ndonjë dyshim i vogël t'ju ndryshojë mendjen, nëse ishit të sigurt në rrugëtimin tuaj dhe keni planifikuar gjithçka me kujdes. Mos u ngadalësoni ose do të humbini avantazhin. Eni përrapa në rrugën tuaj, pa u shpërndruar.

PESHORJA
I keni besuar një personi që e keni njohu së fundmi, dhe tashmë jeni të zhgënjyer nga sjellja e tij jo shumë korrekte. Mashtrimi i Hënës të Peshqit. Mos e ndërlikoni më tej situatën. Mos e prishni ditën dhe pranoni çdo pasojë.

AKREPI
Fundi i muajit po afron dhe ndoshta po afron edhe momenti për të kontrolluar logaritë e shpenzimeve. Mos e harro-ni! Më mirë të mendoni fillimisht për detrytar dhe pastaj për kënaqësinë, ose mund të humbi ndonjë rrugë të rëndësishme.

SHIGJETARI
Dita nis mirë, falë pozicionimit të Hënës të Peshqit. Ndëshmëria juaj do t'ju ndihmojë për të bërë zgjedhjet më të thejeshta, por edhe ato të dëburat. Bëji kujdes ndaj aleatëve të fundit të muajit dhe ndaj mesazheve të rëndësishme që mund të kalojnë pa u vënë re.

BRICJAPI
Tia nisësh me këmbë të mbarë është thelbësore, nëse ndërmerrni një histori e re. Por ju e keni mendjen gjetu dhe nuk dini mirë se çfarë të vendosni. Të merrni një vendim për diçka, ju duket e pamundur në këti moment. Nuk ju mbetet tjetër veçse të prisni.

UJORI
Gjeni pak kohë për personin që doni, përpigui të keni dialog. Do të jetë mënyra më e mirë për të tejkuluar ndonjë tension të mundshëm. Ka shtyrtjen emocionale të duhur, edhe rezultatet mund të mos jenë në lartësinë e duhur.

PESHQIT
Vështirësi të vogla plotësisht të papritura do t'ju shkaktojnë pak probleme, edhe pse e dini t'i përballoi shumë mirë me kokën lart. E keni lumturinë shumë afër, prandaj mos lejoji që asgjë dhe askush, të mos ua marrë!

Trajneri nuk toleron pyetje për lojtarët e grumbulluar, duke u treguar i prerë me gazetarët

Panuçi: Alijin e marr, sepse më pëlqen mua

Priten 3 afrime në miqësoren e muajit mars



Jeton Selimi

Pasi preku nga pranë pjesën më të madhe të futbollistëve të Kombëtares në fazën përgatitore të zhvilluar në Turqi, Kristian Panuçi tashmë i ka idetë më të qarta. Trajneri i Kombëtares është i bindur se Shqipëria ka një bazë të mirë futbollistësh mbi të cilën mund të punohet për të synuar kualifikimin për në Evropianin e ardhshëm. Panuçi do të afrojë 3 lojtarë të tjerë të rinj në Kombëtare për miqësoren kundër Turqisë, paraqitja e tyre, mbi të gjitha e Kamer Qakës e ka impresionuar, por Panuçi nuk ka ndërmend të ndalët pasi premtori afrime të reja për miqësoren e radhës: "Do grumbullohem në mars për një miqësore ku do marrim dy-tre lojtarë që duam t'i shohim për Kombëtaren. Kemi 6 muaj kohë për të formuar grupin që do të provojë të arrijë Europianin. Jam duke vëzhguar 5 apo 6 futbollistë, por nuk dua të



them emra, sepse janë lojtarë të rinj, më mirë të mos them emra".

Eliminimi i Italisë nga Kupa e Botës ishte lajmi më i bujshëm në botën e futbollit, një eliminimi i cili për Panuçin nuk ishte aspak surprizë. Trajneri i Kombëtares shfrytëzoi këtë rast për t'i bërë edhe një kompliment Federatës me anë të

një krahasimi: "Si italian më vjen shumë keq. Por problemi është më i madh nga ç'mendohet, nuk është vetëm eliminimi, është një sistem që nuk funksionon që nga të rinjtë. Në futbollin italian ka shumë vështirësi, sepse shumë njerëz të aftë nuk i lënë të punojnë. Tani skandalizohen për rezultatin, por është pasojë e një

pune. Kam parë me eksperiencën time që shpesh lodhesh të trajnosh në Itali. Unë jam shumë me fat, sepse kam një federatë dhe president që më lë të punoj dhe në fund do më gjykojë. Unë besoj se Shqipëria ka një bazë të mirë, ka shumë shqiptarë në qarkullim. Duhet kërkuar për t'i sjellë në kombëtare. Mund të ndërtojmë një Sh-

qipëri shumë të bukur dhe kjo më intrigon shumë."

Që në herën e parë kur u prezantua si trajneri i ri i Shqipërisë, një nga sloganet kryesore që deklaroi për mënyrën e punës, ishte: "Do të marr futbollistët më të mirë". Mirëpo, trajneri Kristian Panuçi duket se ka nisur të cenojë disi standardet në ekipin Kombëtar. Nëse në grumbullimin e parë bëri shembull Cikalleshin e Xhakën dhe në vijim kërkon respekt për Kombëtaren duke e cilësuar si gjënë më serioze të mundshme, gjatë konferencës së djeshme, tekniku ka dhënë përgjigje disi ndryshe nga kjo linjë e deklaruar prej tij. Në konferencën për shtyp të zhvilluar në ambientet e institucionit të futbollit në vend, Kristian Panuçi u pyet në lidhje me ftesën për Naser Alijin, një futbollist pa skuadër, krahasuar me një sërë alternativash që mund t'u jepej një shans për t'u testuar. Pasi dha disa prej argumenteve të përsëritur se është një futbollist tek i cili beson shumë, Panuçi nervozohet dhe shprehet: "Alijin e marr se më pëlqen. Do ta marr edhe nëse është pa skuadër".

RENDITJA E FIFA-s



Shqipëria ngjitet 9 pozicione, është e 62-ta

Renditja e fundit muajore e FIFA-s e pozicionit Shqipërinë në një vend shumë më të mirë se muajit tetor, plot 9 vende më lart. Shqipëria pozicionohet në vend të 62-të, ndërsa në muajin tetor ishte në vend të 71-të. Një ngjitje e konsiderueshme e kuqezinjve, të cilët arritën të fitonin miqësoren me Turqinë në fushën e kësaj të fundit dhe ky rezultat duket se ka dhënë efekt. Trajneri Kristian Panuçi ka pse të jetë i gëzuar tashmë, ndërkohë që ai ka ambicie të mëdha në krye të Kombëtares dhe në të ardhmen pritet që Shqipëria ta përmirësojë më tej vendin e saj në renditjen e FIFA-s.

KROATI I FLAMURTARIT



Rikuperohet Bushiç, do jetë kapiten ndaj Teutës

Vlonjatët janë fokusuar tashmë të ndeshja me Teutën, që luhet ditën e shtunë. Vendi i dytë ka krijuar në opinionin sportiv vlonjat besimin se ky Flamurtar jo vetëm që mund të jetë në Europë, por ka shanse edhe për titullin. Në skuadër ndërkohë janë më të matur dhe nuk flasin për titull. Për ndeshjen e radhës me Teutën trajneri Duro pritet të ketë të gatshëm edhe kapitenin Bushiç, i cili kishte pësuar një kontraktim musklor në ndeshjen me Lushnjën. Nga klubi vlonjat mësohet se sulmuesi do të dalë sot në stërvitje dhe gjasat janë të mëdha që të shtunën ai të jetë në fushë. Një lajm i mirë ky, pasi Bushiç është shënuesi më i mirë i Flamurtarit në këto 11 javë, me 6 gola.

KAMPIONËT NË KRIZË

Spastrime e ulje pagash, Kukësi në prag të revolucionit



Në janar ose ndoshta edhe më parë, nga kontigjenti i Kukësit do të ketë jo pak largime. Do të ketë një vale spastrimesh, ashtu si të Partizani. Drejtuesit kanë pakënaqësi nga paraqitja e disa lojtarëve me shumë mundësi do t'i largojnë. Flitet edhe për ulje pagash, por gjasat më të mëdha janë për largime, pasi klubi verior e ka paralajmëruar revolucionin. Presidenti Gjici ka pasur kritika shumë të ashpra për mbrojtësin Alla dhe nuk është çudi që edhe ai të largohet, ashtu si Alijev dhe Shtubina. Të gjithë lojtarë larg pritshmëri deri në këtë moment të kampionatit. Por në këtë valë largimesh duket se do të përfshihen edhe lojtarë që nuk kanë luajtur, si Memimi dhe Peposhi. Trajneri Milinković duket se nuk dëshiron të ketë në grup lojtarë, të cilët nuk i bëjnë punë. Para pak ditësh u largua nga Kukësi Hair Zeqiri, për të cilin u tha se e kërkonte vetë largimin, por, në fakt, ka pasur përplasje me tij dhe drejtuesve të klubit. Në janar Kukësi do të pësojë shumë ndryshime, së pari do të bëhen lëvizjet në dalje dhe më pas përforcimet.

Shau Koçin, disiplina pezullon Starovën me 2 ndeshje

PRAG - SKËNDERBEU

Protestat e ashpra të zyrtarëve të ndeshjes në Kukësi i kanë kushtuar dy ndeshje pezullim trajnerit të Partizanit, Sulejman Starovës, i cili u ndëshkua me karton të kuq nga gjyqtari Koçi. Komisioni i Disiplinës në FSHF, pasi ka parë relacionin e ndeshjes në fjalë, ka vendosur që Starova të dënohet me dy ndeshje, që do të thotë se skuadra e kuqe nuk do të ketë në stol trajnerin e saj në sfidën me Skënderbeun të hënën. "I. Zyrtari i KF "Partizani", Sulejman Starova, për protesta me fjalë ofenduese ndaj vendimeve të zyrtarit të ndeshjes, në bazë të nenit 56/1.a të KDS, dënohet me 2 (dy) ndeshje pezullim nga aktiviteti dhe në bazë të nenit 20 të KDS i ndalohet qëndrimi në dhomat e zhyshjes, stolin rezervave dhe territorin përreth fushës." lexohet në komunikatën për shtyp të FSHF-së. Ndërkohë nëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare në "Facebook", klubi i Partizanit



ka publikuar çmimet e bileteve për kryendeshjen e javës së 12-të mes Partizanit dhe Skënderbeut, të cilat do të dalin në treg ditën e shtunë. Ajo që bie në sy janë çmimet e arsyeshme të vendosur nga klubi kryeqytetas për të pasur një pjesëmarrje sa më të lartë të tifozëve. Bi-

leta më e shtrenjtë do të kushtojë 1000 lek dhe bëhet fjalë për në tribunat qendrore A1, A2 dhe B1, B2. Ndërsa çdo tribunë tjetër do të kushtojë 300 lek. Në dispozicion të tifozëve të Skënderbeut do të jenë vetëm tribunat H1 dhe H2.

Ish-ylli brazilian i Milanit, Robinjo, është dënuar me nëntë vite burg nga gjykata e Milanos, pasi është shpallur fajtor për dhunë në grup ndaj një vajze shqiptare. Dhuna, sipas hetimit, është ushtruar nga Robinjo gjatë kohës që luante te Milani, në bashkëpunim me 5 persona të tjerë. Dhuna seksuale, ka ndodhur në 22 janar 2013, dhe vajza shqiptare në atë kohë ishte 22 vjeç. E gjithë kjo histori ka ndodhur në një diskotekë në Milano. Robinjo



Ish-ylli i Realit, Milanit e Çelsit

Dhunoj seksualisht një shqiptare, Robinjo dënohet me 9 vite burg

ka qenë i përfshirë edhe më parë në një histori të njëjtë, në 2009, kur, teksa luante në radhët e Mançester Sitit, u arrestua për përdhunim. 33-vjeçari tashmë është pjesë e skuadrës së Atletiko Minieros në kampionatin brazilian. Në raportin e gjykatës

përmendet se braziliani do të ketë një mundësi për të kundërshtuar dënimin pasi sistemi italian i ligjit lejon "disa nivele apeli" para se të zbatohet ndonjë dënim. Braziliani kërkon të shpëtojë fillimisht futbollisti dhe avokatët e tij e cilësuan si

një formë shantazhi që po i bëhej për shkak se është personazh i njohur. Ai mësohet se në seancat e para gjyqësorë pat deklaruar se ishte një sagesë gjithçka nga vajza shqiptare, pasi nuk kishte arsye që ajo denoncimin ta bënte 6 muaj pasi

kishte takuar Robinjon. Gjithsesi, gjykatësit italianë nuk u ndikuan shumë nga këto pretendime dhe i mëshuan provave, duke arritur në përfundimin se futbollisti 33-vjeçar, katër vite më parë ka dhunuar seksualisht së bashku me 5 persona të tjerë një vajzë shqiptare që sot është 26 vjeç. Prokuroria italiane pat kërkuar disa vite më parë konfiskimin e pasaportës së lojtarit, por gjykata vendosi ta linte të lirë të udhëtonte, sepse ai nuk kishte më mundësi të prishte provat.

Liga e Europës, korçarët fitojnë ndeshjen e tyre të parë në grupin B. Mposhtin ukrainasit 3-2

Skënderbeu thyen Dinamo Kievin, por eliminohet

Partizani i Beogradit siguroi vendin e dytë në grup



Skënderbeu ka arritur një fitore të shkëlqyer përballë Dinamos së Kievit. Kryesuesit e kampionatit shqiptar kanë arritur të përmbysin disavantazhin fillestar për të arritur fitoren e parë në grupin B të Ligës së Europës. Pavarësisht se trajneri ukrainas, Khatskevich, kishte lënë pushim një pjesë të madhe të titullarëve të tij, Dinamo e Kievit është shfaqur agresive në "Elbasan Arena" dhe në minutën e 15-të ka gjetur golin e parë pas kombinimeve të bukura, që u finalizuan me anë të Cigankov në minutën e 15-të. Megjithatë, Skënderbeu është kthyer shpejt në lojë dhe dy minuta më pas ka barazuar me anë të Sabien Lilajt, që siluron nga distanca portën e Bushan. Pjesa e parë do të mbyllet me rezultat të barabartë, ndërsa me fillimin e pjesës së dytë vjen dhe shpërthimi i korçarëve të Ilir Dajës. Në minutën e 53-të Mici harkon në zonë për Ali Soue, me këtë të fundit që ul topin për Xhejmsin dhe nigeriani pak hapa nga porta nuk gabon. 2-1 për Skënderbeun dhe Dinamo tronditet, aq sa në të 57-ën Enis Gavaq do të çajë mbrojtjen ukrainase me një asistim perfekt për Ali Soue. Lojtari nga Gambia shmang edhe portierin për të shënuar golin e tretë të Skënderbeut. Në minutat mbetura, Dinamo e Kievit kërkon të kthehet në lojë, por ka vështirësi për të finalizuar aksionet, ndonëse do të ketë disa raste të mira shënimi.



UEFA. Ndërkohë që presidenti i Skënderbeut, Ardjan Takaj tashmë do t'iu shpërndajë premion 100

mijë euro lojtarëve për këtë fitore. Skënderbeu ka fituar edhe 240 mijë euro nga dy barazimet e arritura në

grup, nga 120 mijë euro për secilën ndeshje ku kanë marrë nga një pikë. Në këtë mënyrë, klubi korçar deri

tani ka përfituar 600 mijë euro nga UEFA pas rezultateve pozitive të arritura në grupet e Europa League.

KAPITENI

Kapiteni i skuadrës së Skënderbeut, Orges Shehi është shprehur shumë i lumtur pas fitores ndaj Dinamos së Kievit. Gardian i korçarëve ka theksuar se ekipi ka fituar shumë eksperiencë. "Ishte një fitore e rëndësishme edhe pse në fund pësum një gol që në fakt nuk duhet ta bënim. Fituar ndaj skuadrës më të mirë të grupit dhe kjo është gjëja më e mirë. Kundërshtarët për fatin tonë të keq fituan dhe do të shkojmë në ndeshjen e fundit do të mundohemi të bëjmë më të mirën tonë."

ISH-TRAJNERI I MADH



Saki, elozhe për Hysajn: Gjithmonë e më i përfshirë te Napoli!

Ish-trajneri i njohur, Arlirio Saki në editorialin e radhës për "La Gazzetta dello Sport" ka folur për momentin e trishtë që po kalon futbollit italian në arenën europiane, ndërkohë që nuk ka mundur një koment edhe për mbrojtësin tonë, Elseid Hysaj. "Albiol dhe Reina nuk kanë gabuar asgjë, ashtu si edhe Hysaj, i cili është gjithmonë e më i përfshirë në lojë e skuadre. Në mesfushë Diavara, vuajtj, por me futjen në fushë të Allan, Luga ndryshoi", ky ishte komenti i ish-strategut të Milanit, i cili ka vlerësuar mbrojtësin shqiptar, pasi ai është një futbollist që luan në disa pozicione për ekipin e drejtuar nga Sarri. Më tej Arlirio Saki bën edhe një analizë për momentin delikat të 3 ekipeve italiane. "Ky është momenti më i trishtë për futbollin italian, teksa Napoli ka menduar që ta zgjidhë disi menjë pjesë të dytë fantastike. Të kaltrit fituan 3-0 ndaj Shakhtarit, në një ndeshje interesante, pasi të dyja skuadrat luajtën futboll total. Napoli është ekipi që të argëton më shumë me një lojë të bukur. Në pjesën e dytë dhuruar spektakël dhe emocione. Sarri ka ndërtuar një skuadër të madhe më saj të punës së mirë të bërë në stërvitje. Championi pa Napoli do të jetë më i varfër, ashtu si kampionati ynë", shkruan Saki në analizën e tij.

NË PORTUGALI

Nën presion nga mediat dhe klubet, arbitrat mendojnë grevën

Profesionit i arbitrit nuk është aspak i thjeshtë, teksa duhet të menaxhojnë shpeshherë ndeshje të vështira dhe episode delikate në duele të caktuara. Ata janë ndër më të kritikuarat jashtë fushave, por në Portugalin e kanë gjetur zgjidhjen për të dalë nga situata e kritikave. Drejtuesit e arbitrave në vendin luftuan kanë kërcënuar me grevë për ndeshjet e radhës në elitën e futbollit portugez si dhe në kategorinë e parë. Gjithsesi, çështja është zgjidhur pas diskutimeve në orët e fundit, edhe pse nuk është vendosur zyrtarisht. Arbitrat ndihen jo gati psikologjikisht pas presioneve të shumta nga mediat dhe ekipet për gjykimin, teksa në rast se ngjarjet do të përsëriten ata kanë kërcënuar me grevë më 15 dhjetor.



ARGJENTINË

Ekzekutohet kapo-ultrasi i Boka Zhuniorit



Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në qytetin e Buenos Airesit në Argjentinë. Kryetari i ultrasve të Boka Zhunior, Gustavo Pereira është vrarë me armë zjarri në shtëpinë e tij. Ish-truproja i boksierit të peshave të rënda Jorge Barrios ishte një nga personat më të rëndësishëm të ultrasve të Bokës. I njohur ndryshe si "Ariu", 49-vjeçari u burgos shumë herë për shkak të trazirave të shkaktuara në stadium. Mediat argjentinase raportojnë se në shtëpinë e Pereirës u gjetën tetë gëzhoja plumbash.

BOTIMI

"Ky Ditërrëfenjës vë gurnë e parë të themelisë për mbrothësinë e kombit tonë dhe bje dashuri të madhe për çdo punë bese, ashtu pra, bekim e vëllazëri që të kuptojnë kombet e huaj se nuk jemi të egër dhe neve shqiptarët, sikundër po na quajnë ata"

"Kalendari Kombiar"

Ridel në dritë një nga kryeveprat e Rilindjes

Në kuadër të 105-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë u prezantua dje në Tiranë, ribotimi i një prej veprave më madhore të Rilindjes sonë Kombëtare, "Kalendari Kombiar". Ai ka qenë realizuar ndër vite nga një grup intelektualësh të shquar të kësaj periudhe si Kristo Luarasi, Kosta Jani Trebicka, Shahin Kolonja, Mit'hat Frashëri, si redaktor kryesor dhe shumë bashkëpunëtorë të tjerë të jashtëm.

Ka qenë fondacioni arsimor - kulturor - humanitar Alternativa për të Ardhmen (ALSAR), që e ka ndërmarrë nismën. Ribotimi i "Kalendari Kombiar" është një lajm i mirë për historinë dhe kulturën shqiptare, tha më tej zoti Mehdi Gurra, sepse risjell edhe një herë atmosferën e viteve të lavdishme të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, përpjekjet e patriotëve shqiptarë, që luftën për liri dhe pavarësi e shihnin, krahas të tjerash, në ndriçimi i mendjes së shqiptarëve, që çdo dije dhe zbulim botëror të ishte i artikulluar në gjuhën shqipe, të kishin veshje dhe identitet kombëtar.

"Ribotimi i ri i 'Kalendari Kombiar' me një tirazh prej 500 kopjes është bërë në origjinal, pa i ndryshuar asgjë, me alfabetet e dikurshëm, me frontespicit, pikturat dhe grafikën e dikurshme. Të vetmet ndryshime, janë se nga 22 vëllime të përvitshme, është përmblodhur në 4 vëllime me letër dhe lidhje speciale për të zvogëluar vëllimin dhe 'ndryshimi' i dytë është se çdo vëllim hapet me nga një parathënie të re, duke futur si parathënie edhe shkrimin e Mit'hat Frashërit, botuar në revistën 'Minerva', nr. 23-24, 1934, tri ditë pas vdekjes së Kristo Luarasisit", - përfundoi prezantimin e veprës, kreu i ALSAR Mehdi Gurra, pa harruar në fund të fjalës së tij të falënderojë edhe njerëz të tjerë që kanë një kontribut të çmuar në ridaljen në dritë të kësaj vepre, siç është nipi i Kristo Luarasisit, prof. dr. Genci Luarasi, për një punë skrupuloze në grumbullimin, ruajtjen, sisteminin dhe përgatitjen grafike të materialit; si dhe donatorët nga Turqia që mundësuan botimin e tij. Rreth veprës me pas, prof. dr. Ferit Duka, prof. dr. Hysen Matoshi, prof. dr. Seit Mancaku, prof. dr. Zeqir Kadriu, prof. dr. Luan Maltezi, prof. dr. Genci Luarasi etj.

KALENDARI KOMBIAR (1897-1916, 1926, 1928)

"Kalendari Kombiar" (1897-1916, 1926, 1928), ishte botim i përvitshëm enciklopedik kulturor; letrar e politik i shoqërisë "Dëshira" të Sofjes. Numri i parë doli më 1897 me titullin "Ditërrëfenjësi" (kalendari) "Kombiar" dhe nga viti 1901 e deri në fund u titullua "Kalendari Kombiar". Gjatë viteve 1897-1900 u drejtua nga Kristo P. Luarasi me Kosta Trebickën dhe më pas edhe me Nikolla Naçon. Pas vitit 1900 botues i vetëm ishte Kristo Luarasi deri në numrin e fundit.

Në vitin 1909-1910 u botua në Selanik; më 1911-1916 përsëri në Sofje.

Më 1926 rinisi botimi në Tiranë nën drejtimin e Mit'hat Frashërit (Lumo Skëndos), i cili mundi të



Në kuadrin e 105-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë ribotohen vëllimet nga 1897 deri më 1928

nxjerrë një numër të fundit në vitin 1928. E gjithë seria përbëhet prej 22 vëllimesh. Në këto botime kanë shkruar artikujt e tyre shumë pena të Rilindjes shqiptare, arbëreshë, etj., sipas tematikave të cilat zgjidheshin nga botuesi. Për rritjen e nivelit kulturor intelektual të lexuesve, krahas autorëve shqiptarë, botuesit kanë përzgjedhur materiale të autoreve të huaj, gjithnjë me një sens për të rritur ndjenjën kul-

turore dhe kombëtare shqiptare. Vihen re edhe materiale të përkthyer nga historia, gjeografia, shkencat e natyrës, teknike etj., ku një peshe të madhe ka pasur Mit'hat Frashëri në sajë të arsimit dhe kulturës së tij gjere.

Me vlerë janë përmblodhjet e bëra të ngjarjeve të vitit të mëparshëm, reklamën e lajmërimet dhe një risi ishte botimi i listës së ndihmëtarëve financiarë anë e



Imazhe të ribotimit dhe origjinalit të "Kalendari Kombiar"

kënd botës, që shërbente si një lidhje mes shqiptarëve që nga Rusia në Argentinë dhe Australia në Amerikën e Veriut. "Kalendari Kombiar" është shkruar me tri alfabetë që përdorehin në atë kohë. Pas vitit 1908 është shkruar me alfabetin e Kongresit të Manastirit, që përdoret edhe sot.

1878, KUR "KALENDARI" QUHEJ "DITËRRËFENJËS"

Parathënia e vëllimit të parë: Të dashur mëmëdhetarë,

Moti i ri 1897, i cili na dhuroj rrojtje të re, dhe fat të mirë, na gëzoj edhe me këtë Ditërrëfenjës (Kalendari), të cilin do ta këndojmë me

zjarr të madh të gjithë neve shqiptarët, që flasin gjuhën shqip. Ky Ditërrëfenjës vë gurnë e parë të themelisë për mbrothësinë e kombit tonë dhe bje dashuri të madhe për çdo punë bese, ashtu pra, bekim e vëllazëri që të kuptojnë kombet e huaj se nuk jemi të egër dhe neve shqiptarët, sikundër po na quajnë ata.

Megjithëse jemi të varfër nga gjithë të tjerët, po dashuria për mëmëdhenë dhe dëshira që kemi për të hapurit e gjuhës sonë, dalëngadalë, me emrin e të Madhit Zot së pari, do hapim qëllimet tona dhe do të vinjë kohë që do të hapen dhe kishë mbë gjuhën Shqip si kundër

kanë hapur dhe Kombet e tjerë. Të kemi dashuri me njëri tjetrin, të jemi të bashkuar të gjithë tok: të Krishterë e Myslimanë; të ndihmojmë sa të mundet për çdo farë pune të shenjtëruar; të mos qajmë e përçmojmë gjuhën e mëmës sonë, por sa të mundim ta lavdërojmë së gjithash etj., etj. Këto janë detyrat e një mëmëdhetari që ngashëron mbrothësinë e gjuhës së vetë. Këtë Ditërrëfenjës që na i dhuroj e ndiçmja Shoqëri e Sofjes "Dëshirë" e bëmë format më të madh pakë, meqenëse kemi nevojë të madhe fjalë më shumë, si ndonjë vjershë, këngë, a përrallë të Kombit. Me nder (K. I. T.)

Rexhep Qosja: Pse pat vlerë "Kalendari Kombiar"

Është një revistë të përvitshme, një revistë me emër në historinë tonë të çmuar kulturore, që kishte filluar të dilte në vitet e fundit të Rilindjes sonë të madhe Kombëtare, në vitin 1897, kohë kur ishin përforcuar e përshtirë shumë përpjekjet për krijimin e shtetit kombëtar - Shqipërisë. "Kalendari Kombiar" me përmbajtjen, me idetë, me mendimet, me vlerësimet e ndjenjat e shprehura në të ishtë dhe mbeti dëshmi dhe frymëzim i këtyre përpjekjeve. Ju keni botuar dhe po përuoni të përmblodhur në katër vëllime një revistë, që do të vazhdojë të botohet, me disa ndërprerje rrjedhojë e vështirësive jo vetëm financiare, deri në vitin 1928, kur po bëheshin përpjekje të mëdha për krijimin e institucioneve dhe për qëndrueshmërinë e shtetit shqiptar, të shqetësuar prej mospajtimeve me pavarësinë e tij të fuqjive dhe prej ballafaqimeve shpesh




shpërbërëse të pjesëtarëve të parisë vendore!

Ju keni botuar dhe po përuoni një vepër të madhe me karakter enciklopedik, në të cilën do të sillen të dhëna nga shumë fusha të jetës së përtashme dhe historike të popullit shqiptar, në të cilën do të sillen të dhëna nga fusha të ndryshme të historisë, kulturës, dijeve, arteve dhe të shumë popujve të

tjerë. Dhe, duke e botuar "Kalendari Kombiar" në katër vëllime, ju keni botuar dhe po përuoni një vepër të madhe që i ka rritur, i ka shtuar, i ka pasuruar: vetëdijen kombëtare, dijet, artet, letërsinë, kulturën, qytetërimin shqiptar dhe lidhjet e tij para së gjithash kulturore me shumë popuj të tjerë. Dhe, kështu, ju keni botuar e po përuoni një vepër të madhe, që

kujtesës sonë të pakujdesshme sidomos gjatë dy dhjetëvjetëshave të fundit, po ia rikthen emrin shumë të merituar të botuesit të saj të parë, Kristo Luarasisit, botuesit të saj të dytë, Mit'hat Frashërit dhe të një vargu veprimtarësh të tjerë politikë, shoqërorë, letrarë, kombëtarë, që gjithë jetën e tyre, shpesh duke harruar veten, ia kushtuan kombit të vet dhe shtetit të tij, natyrisht në kufijtë etnikë. Ju uroj me shumë përkushtim për këtë vepër të madhe dhe ju dëshiroj që me botime të tilla që të rëndësishme si "Kalendari Kombiar" e si gjithë ato që më dhurojat të vazhdoni veprimtarinë tuaj të rëndësishme arsimore, kulturore e humanitare. Dhe, gjithëkombëtare.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashtë.
- Është Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhen për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë troutaret.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë.
- Preka komik shkrorran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ënte Operative Tiranë
- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.

- Është përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Është e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë.
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementi.
- Ishte nija që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titanëve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

VERTIKAL

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Është metri i rrobaqepësit.
- Një hyrje të oazit.

8. Arte pa re.

- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë.
- Ishin monedhe të Tobias.
- Është bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Është marrëveshje me nota.
- Ishte babai i Akiit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Është faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Writen nga espada.
- Është shtet aziatik.
- Edouard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Unë i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samurai.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Është ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.
- Ënte Ekonomike Sarandë.
- Mbyllin një ditar.

36. Satelit i Jupiterit

- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Është kolana në filma
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Është tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.


VERTIKAL

- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Është edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamijeve
- Notat pa kufij.




- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castelliito aktor.
- Inicialet e Dali, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Është trysni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobaz për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktore.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	2	4	1	5		6			
		5			4			3	
8		9			2		4		
		6		7			3	2	
7			3		9			8	
1	4			8		9			
	6		9			3		5	
2			8			1			
	9			1	3	2	7		

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	8	4	7	2	9	6	3	5	
2	3	7	4	6	5	8	1	9	
5	9	6	1	3	8	2	7	4	
7	2	8	9	5	1	4	6	3	
6	4	1	2	8	3	9	5	7	
9	5	3	6	7	4	1	2	8	
3	1	2	8	9	7	5	4	6	
4	7	9	5	1	6	3	8	2	
8	6	5	3	4	2	7	9	1	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Nëse njerëzit do të dinin sa shumë duhet të bënin për të arritur suksesin, shumica e tyre nuk do t'i hynin asaj rruge.
(Lord Tomson i Flotës)
- Sekreti i fitores qëndron në organizimin e gjërave jo të qarta.
(Kristofer Morley)
- Kur virtyti ka qenë i fjetur, ai zgjohet më i freskët.
(Fridrih Nice)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2	7	3	13		2	
2	7	5		8	4	3	5	7	2
7		3	1	9	1	6	5	10	6
	3	5	8	2	3	5	6	1	7
12	5	13	5	10	1	7		6	13
2	7	18		5	11	2	6	5	8
8	2	6	2	2	2	1	8	5	11
1	6	8		17	9	5	7	2	
3	1	5		8	2	16		2	7
2			3	2	6	5	9	2	1
6	2	7	2			3	7	18	1
3	4	8	5	19	1	5		3	5

K	A	F	E		T	A	L	E	N	T
A	D	A	M		P	A	F	T	E	R
T	E	T		H	E	P	A	T	I	T
E	T		H	E	R	E	T	I	K	E
G		K	O	M	I	T	E	T	E	T
O		E	K	I	P	E	T	T	A	F
R	I	K		N	E	T		T	A	P
I		O		G	C			S	T	I
K	P		S	W	I	N	G		S	L
E	O		P	A	T	E	N	T	A	T
N	A		Y	E				U	R	A
T	Y	M	I		P	I	R	A	T	I

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

S	A	R	A	B	A	D	P	L	A		
A	D	D	E	S	I	D	E	R	I	U	S
T	E	B	U	R	I	D	A	N	I	I	K
R	R	A	H	A	R	A	K	I	R	I	E
A	B	A	T	E	S	S	J	V	I	T	E
P	I	T	O	N	I	H	D	A	N	A	E
H	A	S	I	M	U	R	I	D	I	A	L
S	U	A	I	P	A	R	T	E	J	E	L
G	J	A	K	U	Y	R	E				
K	I	N	I	N	A	P	R	O	T	E	U
T	D	E	D	I	T	H	S	A			

FJALËKRYQI (1)

C	L	A	U	D	E	K	N	G	O	L	
S	A	G	A	N	G	A	N	I	M	E	D
O		K	A	M	I	K	A	Z	E		
L	A	R	P	A	G	A	N	I	N	A	
O	K	A	K	L	A	S	I	O	M	A	
K	E	F	A	K	U	V	L	I	K	A	
A	R	O	S	A	K	T	E	T	E	M	
L	O	B	T	N	R	T	E	A			
N	I	C	O	T	A	H	E	R	O	I	
S	T	A	U	I	P	O	N	K			
P	I	S	T	A	M	O	S	T	I	E	
Y	A	R	D	E	M	E	T	R	A		

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mëçuara

- Mendojnë për të ardhmen me shqetësim, dhe harrojnë të tashmen, nuk e jetojnë të tashmen e as të ardhmen, (i humbin të dyja).
- Njerëzit mërziten nga fëmijëria, nxitojnë të rriten, më pas shpresojnë të kthehen të vegjël (fëmijë) përsëri.
- Asnjë nuk është e vogël për një mendje të madhe. (Sherlok Holms)
- Për të njohur vetveten, duhet ditur gjithçka për të tjerët. (Oskar Uajld)

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

